

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5672
E enjte, 10 janar 2019
çmimi 0.40 €

OVLUÇK-ja: Gjykata Speciale, e njëanshme

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

TAHIRI: ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL, PRIORITETI KRYESOR PËR KOMUNAT NË 2019-n F. 3

KDI DHE OJQ-të KËRKOJNË NGA GJASHTË KOMUNAT NDËSHKIM PËR MOSPËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT F. 6

189 RASTE TË PACIENTËVE PËR 24 ORË NË EMERGJENCË F. 6

EKONOMI



HARADINAJ: DOGANA, NJË NGA INSTITUCIONET MË TË BESUESHME NË VEND F. 8

KEK-U IMPLEMENTON SHËRBBIMET E FUNDIT TEKNOLOGJIKE TË VALA-S F. 8

KULTURË

NËNSHKRUHET PROGRAMI NACIONAL PËR RININË EDHE ME KOMUNËN E KAMENICËS

F. 13

SPORT

TAULANT XHAKA NË GARË PËR GOLIN E VITIT NË ZVICËR F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHYQIRI BYTYQI | FAQE 4-5

Besoj se do të arrijmë ta parandalojmë grevën

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije se janë duke punuar për ta gjetur zgjidhjen e duhur për ta parandaluar grevën e SBASHK-ut të paralajmëruar më 14 janar. Ai ka thënë se, përveç ndaljes së grevës, qëllimi i MASHT-it është

edhe realizimi i kërkesave të SBASHK-ut, përkatësisht ngritja e koeficientit për mësimdhënës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bytyqi ka deklaruar se me ngritjen e koeficientit dhe përcaktimin e të ardhurave të mësimdhënësve në karrierë nuk do të ketë

nevojë për grevë. Ai ka thënë se gjendja në sistemin arsimor në Kosovë nuk është e mirë por, sipas tij, tashmë janë marrë hapa konkretë dhe pritet rritje graduale e cilësisë në arsim. Sa iu përket shkollave profesionale, ministri Bytyqi ka thënë se në këtë vit do të fillojë një etapë e re

Kritikohet paraqitja e delegacionit shtetëror në Bruksel

Për takimin e parë në Bruksel delegacioni shtetëror i Kosovës për bisedime me Serbinë ka marrë kritika nga opozita dhe njohësit e rrethanave politike. Sipas liderit të LDK-së, Isa Mustafa, në takimin e parë ky delegacion u mor me vetveten dhe jo me esencën e dialogut. Kurse analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë se përballja e parë me shefen e politikës së



jashtme të BE-së, Federica Mogherini, nuk la shije të mirë edhe në aspektin gjuror



Minatorët kërkojnë rritje të pagave, gjendja financiare në 'Trepcë' jo e mirë

FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Është izoluar rasti i parë i gripit A në këtë sezon

PRISHTINË, 9 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se është duke e përcjell me vëmendje ecurinë epidemiologjike të gripit sezonal në tërë territorin e vendit duke intensifikuar punën në terren. "Nga 1 tetori (2018) deri më 9 janar 2019 në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 17 119 raste të dyshimta me grip, 29 148 raste të infeksioneve respiratore akute dhe 16 raste të rënda respiratore akute. Rastet raportohen nga të

gjitha komunat e Kosovës, me përjashtim të komunave me popullatë serbe. Numër më i madh i rasteve raportohet nga Komuna e Prishtinës", është thënë në njoftimin për media. Sipas IKShPK-së, Komuna e Prizrenit dhe Podujevës nga muaji tetor ka pasur rritje të lehtë të rasteve përgjatë muajve pasues nëntor dhe dhjetor, por nuk kalon pragun epidemik", thuhet në njoftimin e IKShPK-së. "Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Gripit - IKShPK deri më 9 janar 2019 janë testuar

gjithsej 76 mostra të dyshimta në grip. Sot, më 9. 1. 2019, nga laboratori i IKShPK - Qendra Kombëtare e Gripit, është konfirmuar një rast pozitiv në Influençën A. Instituti Kombëtar tashmë ka dhënë rekomandime të duhura profesionale, që qytetarët të kenë kujdes dhe të mos dalin gjatë në ambiente të ftohta, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina. Aktualisht situata epidemiologjike është nën kontroll




sa i përket gripit sezonal, por me gjendjen aktuale klimatologjike që po mbretëron në Kosovë,

ekziston mundësia e rritjes së rasteve", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Kuvendi i Maqedonisë pritet ta nisë debatin për zbatimin e Marrëveshjes me Greqinë

Deputetët duhet ta votojnë ndryshimin e katër amendamenteve me qëllim të harmonizimit të Kushtetutës me Marrëveshjen që ishte arritur në qershor të vitit 2018 dhe në bazë të amendamenteve, Maqedonia pranon se identiteti dhe gjuha maqedonase nuk ka lidhshmëri me Maqedoninë Antike



SHKUP, 9 JANAR - Faza e tretë dhe e fundit e ndryshimeve kushtetuese ndodhet për miratim në Kuvendin e Maqedonisë dhe, nëse kalon me dy të tretat e nevojshme të votave, rumbullakohet zbatimi i Marrëveshjes me Greqinë për emrin e ri të shtetit, Maqedonia e Veriut.

Deputetët duhet ta votojnë ndryshimin e katër amendamenteve me qëllim të harmonizimit të Kushtetutës me Marrëveshjen që ishte arritur në qershor të vitit 2018, si preambulën, zëvendësimin e të gjithë mbiemrave maqedonas me të, çështjen e kujdesit ndaj diasporës, atë për gjuhën dhe trashëgiminë kulturore. Në bazë të amendamenteve, Maqedonia pranon se identiteti dhe gjuha maqedonase nuk kanë lidhshmëri me Maqedoninë Antike. "Kemi një proces për ndryshimin e Kushtetutës që synohet të arrihet përmes ndërrimit të emrit kushtetues,

përmes pazareve politike, shantazheve e kërcënimeve të ndryshme, pasi pushteti këtë nuk arriti ta bëjë në referendum i cili u hodh poshtë nga populli. Marrëveshja e arritur është e dëmshme dhe për ne do të jetë e papranueshme", ka deklaruar kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski duke bërë thirrje për protesta para Kuvendit, ku ndodhen edhe një grup tjetër i protestuesve i thirrur nga disa subjekte politike e organizata pro-ruse.

Ndërkohë, miratimi i ndryshimeve kushtetuese mbetet i paqartë edhe për shkak të kërkesave të opozitës shqiptare, kryeministri Zoran Zaev ka takuar kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela dhe atë të Lëvizjes Besa, Bilall Kasami, dy parti këto opozitare që kanë kushtëzuar katër votat e tyre me pranimin e disa amendamenteve me të cilët

pretendojnë të përmirësojnë pozitën juridike të shqiptarëve në kushtetutë.

Kryeministri Zaev tha se ka pranuar kërkesat e partisë së Zijadin Selës që ka të bëjnë me preambulën, diasporën dhe tjetrën me Kosovën e cila tani në Kushtetutë do të jetë shtet fqinj i Maqedonisë, pasi deri tani ajo nuk figuronte në aktin më të lartë juridik në vend. "Fjalja e parë e Kushtetutës, preambula do të heq padrejtësinë e definimit të gjërave, në formën e dy kategorive të qytetarëve, që i bën

qytetarët më të barabartë dhe gjithsecili shihet veten më të përfaqësuar në Kushtetutë", ka deklaruar kreu i Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela.

Sa i përket kërkesës tjetër për gjuhën shqipe, Sela tha se ajo për momentin është e përcaktueshme, por se nuk do të heqë dorë që në të ardhmen edhe kjo kërkesë të plotësohet e që ka të bëjë me zëvendësimin e termit, gjuhë që e flasim 20 për qind e popullatës, me termin adekuat, gjuha shqipe.

Ndërkohë, gjatë debatit mbetet

të shihet edhe marrëveshja eventuale me partinë tjetër opozitare, Lëvizja Besa e cila veç tjerash kërkon ndryshime edhe në pjesën e shtetësisë apo dokumenteve personale. Ajo kërkon që të mos qëndrojë grafa "maqedonas/shtetas i Maqedonisë së Veriut", por vetëm shtetas, pa përcaktimin maqedonas, apo nëse qëndron ky përcaktim atëherë edhe bashkësitë etnike të kenë të drejtën e përcaktimit, si "shqiptar/shtetas i Maqedonisë së Veriut".

Meta: Dekretimi i ministrit të ri të Jashtëm varet nga përgjigjja e institucioneve

TIRANË, 9 JANAR - Presidenti Ilir Meta deklaroi se emrat e ministrave që ende nuk janë dekretuar, po verifikohen sipas ligjit. I pyetur nga gazetarët, Meta u përgjigj se "për të gjithë emrat e rinj apo figurat e reja që promovohen për ministra, pra që propozohen si të tillë, po bëhet detyra normale, me shumë përgjegjësi për verifikimin e integritetit të tyre në mënyrë që ta respektojmë insti-

tucionin e ministrit, si një institucion shumë të rëndësishëm kushtetues".

I pyetur konkretisht për dekretimin e emrit të kandidatit për ministër të Jashtëm, Gent Cakaj, presidenti tha se vendimi i Presidencës do të varet nga koha kur institucionet zyrtare që janë pyetur për informacion do t'i kthejnë përgjigjet. "Brenda afatëve dhe sa më shpejt që të jetë e

mundur, jo duke pritur orët e fundit. Por kjo do të varet nga përgjigjja e institucioneve që ne u jemi drejtuar. Do të bëjmë të gjitha veprimet përfundimtare dhe publike, me transparencë maksimale", deklaroi Meta.

Kreu i shtetit vizitoi të mërkurën Kavajën në kuadër të nismës së ndërmarrë së bashku me "Aleancën për Dhurimin e Gjakut".



Takimi i parë i delegacionit shtetëror të Kosovës për bisedime me Serbinë në Bruksel ka nxitur reagime

Kritikohet paraqitja e delegacionit shtetëror në Bruksel

Për takimin e parë në Bruksel, delegacioni shtetëror i Kosovës për bisedime me Serbinë ka marrë kritika nga opozita dhe njohësit e rrethanave politike. Sipas liderit të LDK-së, Isa Mustafa, në takimin e parë ky delegacion u mor me vetveten dhe jo me esencën e dialogut. Kurse analisti politik, Imer Mushkolaj, ka thënë se përballja e parë me shefen e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, nuk la shije të mirë edhe në aspektin gjinor

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 JANAR - Opozita dhe analistët politikë kanë kritikuar paraqitjen e delegacionit shtetëror të Kosovës në takim me shefen e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se ky delegacion ishte jorelevant, kurse analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë se delegacioni shpërfaqti një arrogancë mashkullore. I pari i LDK-së ka vlerësuar se punën e gjithë këtij ekipi më herët e bënte vetëm ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri. "Kosova u përfaqësua në Bruksel nga një delegacion pa relevancë. Mos të flas për numrin. Më parë, me kompetencë, një ministre e bënte punën e gjithë atyre që ishin në Bruksel. Ajo që dëgjuam ishte se ata e morën një porosi të qartë. Se duhet të kthehen në Kosovë ta heqin taksën si parakusht për dialogun", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se bashkëkryesuesit në deklaratat e tyre nga Brukseli u munduan t'i tregojnë Kosovës

se kush janë. "Ata u morën me vetveten, jo me esencën e dialogut; u morën me taksën, pa dhënë përgjigje. Dhe, u morën me LDK-në. LDK-ja konsideron se dialogu me Serbinë është çështje shumë serioze për Kosovën. Një çështje serioze duhet të ketë qasje serioze dhe institucione që e përfaqësojnë me legjitimitet. Jo njerëz që shkojnë në Bruksel për ta përgjuar opozitën. Logjika dhe kultura evropiane nuk i kultivon dhe nuk i preferon sjelljet e tilla. Kosovën në Bruksel duhet ta përfaqësojë një Qeveri me përkrahje të gjerë, e cila për çështje të dialogut arrin të sigurojë unitet. Ndryshe, të tjerët do na i bëjnë letrat e ne do të vazhdojmë të përplasemi ndërmjet vete", është shprehur lideri i LDK-së, Isa Mustafa.

Ndërsa njohësi i rrethanave politike në vend, Imer Mushkolaj, mendon se ekipi negociator ka lënë shije të keqe në Bruksel edhe sa i përket përfaqësimit gjinor. "Qasja e tillë e përfaqësimit në dialog vetëm e shpërfaq mënyrën se qysh qeverisjet në Kosovë, në kuptimin e arrogancës mashkullore në këtë rast. Ne e dimë se postet qen-

drore institucionale i mbajnë burrat dhe vërtet ishte një pamje e keqe ajo e takimit të delegacionit të Kosovës me Mogherinin. Është e pafalshme se qysh subjektet politike edhe në krijimin e ekipit negociator nuk e gjeten asnjë grua që, sipas tyre, mund të jetë pjesë e këtij ekipi dhe ta përfaqësojë Kosovën", ka thënë Mushkolaj. Ai ka deklaruar se ky delegacion në proces do të jetë vetëm konsultativ. "Zonja Mogherini e tha atë që tashmë dihet, se dialogu do të zhvillohet në nivel të presidentëve dhe duket se përnjëmend delegacioni është vetëm konsultativ. Nuk e di se me kënd do të negociojë ky ekip negociator kur, në anën tjetër, pra te pala serbe nuk e kemi një ekip të

tillë", është shprehur ai. Sipas Mushkolaj, tashmë ekziston një kornizë e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nëse, siç po thuhet, marrëveshja do të arrihet shpejt, e që i bie brenda pak muajsh, atëherë çdo njeri me mendje të shëndoshë mund ta kuptojë se asnjë marrëveshje kaq e rëndësishme siç mund të jetë kjo me Serbinë nuk mund të arrihet me kaq pak negociata. Duket se një kornizë e marrëveshjes dhe disa bisedime jopublike janë kryer dhe, në një farë forme, derisa palëve t'u ofrohet një marrëveshje që ata ta pranojnë ose jo", ka thënë Mushkolaj. Ekipi negociator i Kosovës ka realizuar të martën një takim konsultues me zyrtarët e

Bashkimit Evropian. Pas takimit, shefja për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, ka thënë se ka kërkuar që Kosova ta heqë taksën prej 100 përqindësh të vënë në muajin nëntor. Ndërsa udhëheqësit e delegacionit shtetëror pas takimit kanë thënë se ia kanë paraqitur zonjës Mogherini kërkesat e tyre për këtë proces. Sipas tyre, tani pritet një dinamikë tjetër e këtij procesi. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i këtij procesi, ka kërkuar që të dyja palët në fund të këtij procesi të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e plotë të marrëdhënieve, e cila, pos të tjerash, do t'ua hapë perspektivën evropiane të dy shteteve.

Tahiri: Zhvillimi ekonomik lokal, prioriteti kryesor për komunat në 2019-n

PRISHTINË, 9 JANAR - Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka prituri të mërkurën në takim përfaqësuesen e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) në Kosovë, Saranda Cana-Pruthi, drejtuesin e projektit DEMOS Norbert Pijls dhe sekretarëshën e përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Rozafa Ukimeraj.

Tahiri ka theksuar se sa i përket qeverisjes lokale janë dy synime kryesore ku do të fokusohet puna e Qeverisë së Kosovës. "Kryeministrin Haradinaj prioritet kryesor për këtë vit e ka zhvillimin ekonomik në nivel



vendi. Fokus i veçantë në punën me komuna do t'i kushtohet zhvillimit ekonomik lokal (LED). Për këtë do të punohet në fusha sektoriale nga niveli qendror

dhe në koordinim të ngushtë me komunat dhe partnerët zhvillimorë për t'i orientuar fondet zhvillimore në funksion të zhvillimit ekonomik lokal dhe gjener-

imit të punësimit. Kjo do të realizohet në orientim me Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, duke synuar përmbushjen e objektivave, si rritja e qëndrueshmërisë financiare e komunave, tërheqja e investimeve të huaja, fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor dhe shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik", ka thënë Tahiri, duke folur edhe për synimin e dytë. "Analiza e plotë funksionale e qeverisjes lokale për t'i identifikuar në hollësi problemet në lidhje me kompe-

tencat, financimin dhe nevojat e komunave, e për të filluar një proces të strukturuar dhe agjendë afatgjatë të reformimit të qeverisjes lokale. Lidhur me këtë, diskutuam për koordinimin dhe mbështetjen e cila do t'i ofrohet Kosovës nga partnerët zhvillimorë, ndër më të rëndësishmit, siç është edhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC), si dhe u shkëmbyen ide për zgjidhjen e problemeve të shumta aktuale që ndërlidhen me nivelin lokal", ka thënë Besnik Tahiri, koordinator Nacional për Reforma Shtetërore.

Flet për "Epokën e re", Shyqiri Bytyqi

Besoj se do të arrijmë ta



Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije se janë duke punuar për ta gjetur zgjidhjen e duhur për ta parandaluar grevën e SBASHK-ut të paralajmëruar më 14 janar. Ai ka thënë se, përveç ndaljes së grevës, qëllimi i MASHT-it është edhe realizimi i kërkesave të SBASHK-ut, përkatësisht ngritja e koeficientit për mësimdhënës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bytyqi ka deklaruar se me ngritjen e koeficientit dhe përcaktimin e të ardhurave të mësimdhënësve në karrierë nuk do të ketë nevojë për grevë. Ai ka thënë se gjendja në sistemin arsimor në Kosovë nuk është e mirë por, sipas tij, tashmë janë marrë hapa konkretë dhe pritet rritje graduale e cilësisë në arsim. Sa iu përket shkollave profesionale, ministri Bytyqi ka thënë se në këtë vit do të fillojë një etapë e re

cionale të gjejmë zgjidhje. Edhe në takimin e përbashkët me kryeministrin kemi shprehur gatishmërinë që të gjejmë zgjidhje për të dalë nga kjo situatë. Jemi duke punuar me këshilltarët e kryeministrit dhe SBASHK-un që të kemi një propozim për komisionin parlamentar për një ndryshim pozitiv të koeficientit aktual. Besoj se do t'ia arrijmë që të mos ketë grevë në Kosovë. Qëllimi ynë është ta ndalim grevën dhe t'i realizojmë kërkesat e zbatueshme. Për zgjidhjen e zbatueshme do të përfshihet ngritja e koeficientit dhe propozimi që mësimdhënësit në karrierë të kenë të ardhura shtesë. Me ngritjen e koeficientit dhe përcaktimin e saktë të të ardhurave të mësimdhënësve në karrierë besoj se nuk do të ketë nevojë për grevë.

vendimi sot apo nesër se do të realizohen kërkesat sepse kjo varet nga komisioni parlamentar dhe për këtë duhet të bisedojmë me komisionin. Por SBASHK-u ka për obligim t'u përcjellë mësimdhënësve se Ministria e Arsimit dhe Qeveria kanë gatishmëri të madhe për të gjetur zgjidhje. Ky është një lajm i mjaftueshëm që të mos ketë grevë. Fillimi i grevës do ta dëmtonte procesin mësimor dhe do të shkaktonte probleme të tjera. Nëse SBASHK-u parandalon grevën do ta kemi më lehtë zgjidhjen e problemit. Sidoqoftë, në angazhohemi që mësimdhënësit të trajtohen siç duhet sepse kjo nuk është përgjegjësi e jona, por e Ministrisë së Administratës Publike. MASHT-i nuk ka pasur ndikim në përcaktimin e koeficientit të mësimdhënësve, por ka qenë vullnet që mësimdhënësit të mos trajtohen në këtë mënyrë. Për këtë kemi ngritur zërin dhe kemi qenë të gatshëm të jemi partnerë me

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHINË, 9 JANAR -

"Epoka e re": Z. Bytyqi, a keni arritur ta bindni SBASHK-un për të hequr dorë nga greva e paralajmëruar më 14 janar nëse nuk plotësohet kërkesa juaj, pra ndryshimi i koeficientit për mësimdhënës në Projektligjin për paga?

Bytyqi: Në vazhdimësi kemi bashkëpunim të mirë me

SBASHK-un dhe kemi adresuar problemet për të gjetur zgjidhje. Projektligji për paga duhet të ketë trajtim më të mirë për mësimdhënës dhe në letër drejtuar Ministrisë së Administratës Publike kemi shprehur mospajtimet për renditjen e koeficientëve për mësimdhënësit. MASHT-i ka dërguar propozimin konkret për radhitjen e koeficientëve për mësimdhënës për të gjitha kategoritë. E kemi bërë zgjerimin e

listës sepse është një listë e ngushtë për nivelin e mësimdhënësve përfshirë tashmë ndarjen që kemi në shkolla fillore, të mesme e ulët, të mesme e lartë, ndërsa në projektligj janë të ndara në dy pjesë: shkolla e mesme dhe shkolla fillore. Edhe në Qeveri e kemi ngritur zërin se nuk pajtohemi me këtë renditje, madje kam votuar kundër këtij projektligji. Megjithatë, me SBASHK-un kemi insistuar që në mënyrë institu-

"Epoka e re": Keni marrë sinjale pozitive nga SBASHK-u për pezullimin e grevës?

Bytyqi: Nuk mund të merret

parandalojmë grevën

në Kosovë nuk është e mirë, por në vitet e fundit janë duke u bërë përpjekje të mëdha që të ndryshohet kjo gjendje. Janë identifikuar problemet dhe tani jemi në fazën e implementimit për të ndryshuar situatat që e kanë shkaktuar rënien e cilësisë në arsim. Nuk është e lehtë të ndryshohet menjëherë gjendja në arsim sepse kërkon angazhim të përgjithshëm dhe reforma të mirëfillta. Çdo përpjekje për ta ndryshuar gjendjen dhe për të pasur një sistem siç e kanë vendet e zhvilluara nuk mund të sjellë rezultate të menjëhershme. Megjithatë, kemi marrë hapa konkretë dhe presim gradualisht, çdo vit të kemi rritje të cilësisë në arsim.

"Epoka e re": Në këtë rrugëtim e keni mbështetjen e partnerëve qeverisës?

Bytyqi: Qeveria Haradinaj ka futur si prioritet sistemin arsimor, por gjatë kësaj periudhe ka pasur zhvillime politike të rëndësishme të cilat e kanë larguar vëmendjen nga arsimi. Megjithatë, falë përkushtimit të Qeverisë dhe MASHT-it, kemi arritur që në vitin 2019 të ketë trajtim më të mirë në buxhet, edhe pse jo në nivelin e dëshiruar. Kemi rritje buxhetore dhe në këtë vit do të ketë orientim më të mirë në sistemin arsimor.

"Epoka e re": Cili është bashkëpunimi i Kosovës me Shqipërinë në aspektin arsimor?

Dhe cilat janë angazhimet e MASHT-it për mbështetjen e arsimimit dhe edukimit të fëmijëve shqiptarë që jetojnë në Mal të Zi, Maqedoni si dhe fëmijëve shqiptarë në diasporë?

Bytyqi: Ministria e Arsimit në Kosovë dhe Ministria e Arsimit në Shqipëri kanë bashkëpunim shumë të mirë dhe synojnë të shkojnë drejt një sistemi unik të arsimit në Kosovë dhe Shqipëri. Në këtë drejtim kemi bashkëpunim në trajtime të mësimdhënësve, në çështjen e kurrikulave që i kemi të njëjta dhe po interesohemi që edhe në sistemin e arsimit të lartë të kemi bashkëpunim më të afërt. Me homologen time jemi pajtuar të kemi edhe shkëmbim të kuadrove, sidomos në programet deficitare. Jemi në rrugë të mbarë për ta ndihmuar njëri-tjetrin meqë me bashkëpunim mund t'i tejkalojmë problemet në sistemet tona arsimore. Synojmë që edhe për profesionet e rregulluara të kemi një komision të përbashkët që do të merret me përpilimin e provimit të profesioneve të rregulluara, pastaj këto profesione të njihen në mënyrë automatike. Kurse sa i përket pjesës jashtë Kosovës dhe Shqipërisë në 2018-n është bërë një punë e madhe duke u finalizuar kurrikulat e përbashkëta për diasporë të cilat do të jenë në përdorim nga ky vit. Dërgojmë libra falas për diasporën dhe ky bashkëpunim me Shqipërinë shkon edhe një hap më tutje sepse planifikojmë

financimin e përbashkët për mësimdhënësit në diasporë në mënyrë që nxënësit shqiptarë të mësojnë shqip. Ndërsa sa i përket Malit të Zi, MASHT-i e ndihmon shumë, sidomos në shpërndarjen e abetares falas për fëmijët shqiptarë. Ndërkaq, kur flasim për Luginën e Preshevës, kemi probleme politike, ndalesa nga shteti serb dhe nuk kemi arritur që as librat t'i dërgojmë. Jemi në diskutime me Shqipërinë për të gjetur mundësi për t'i kaluar këto probleme sepse Serbia refuzon çdo lloj bashkëpunimi apo përkrahje që Kosova e Shqipëria tentojnë t'i japin Luginës.

"Epoka e re": Çfarë jeni duke bërë sa i përket hapjes së shkollave profesionale, sepse në vendin tonë po ka mungesë të zhvillimit të profileve profesionale?

Bytyqi: Nuk na mungojnë shkollat profesionale, por nuk janë të profilizuara. Profilin nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe në këtë drejtim jemi duke punuar. Aktualisht po planifikojmë të zhvillohen 15 standarde profesionale që janë në përputhje të plotë me kërkesat e tregut. Këtë vit parashohim 'ndërtimin' e dhjetë shkollave me programet më të kërkuara në tregun e Kosovës dhe ky projekt do të financohet nga GIZ-i dhe Qeveria e Luksemburgut. Po përipiemi të kemi një orientim në karrierë për nxënësit, pra ata shkollën profe-

sionale mos ta shohin si shkollë për nxënësit e dobët, por që të jetë shkollë për ta gjetur talentin e tyre, pastaj ata të jenë të gatshëm për tregun e punës në moshën 18-vjeçare. Në këtë vit fillon një etapë e re për shkollat profesionale në Kosovë.

"Epoka e re": Ministër, sa keni arritur të bëni ndryshime në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në universitetet publike dhe në kolegjet private?

Bytyqi: Nuk është e lehtë të ndryshohet gjendja menjëherë në universitetet publike dhe kolegjet private. Megjithatë, i kemi bërë disa hapa pozitivë, duke vendosur rregulla dhe disiplinë në këto institucione. Për herë të parë vitin e kaluar kemi vendosur rregull se cila është data e fundit kur studentët mund të regjistrohen dhe ky është një kontroll se si po bëhet regjistrimi i tyre. Tashmë kemi Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) të pavarur me njerëz profesionalë. Këtë vit Agjencia do ta fillojë monitorimin e cilësisë brenda kolegjeve private dhe universiteteve publike. Për herë të parë në terren do të kemi zyrtarë të Agjencisë që jo vetëm do ta kryejnë detyrën e akreditimit, por do të shikojnë zbatimin e obligimeve dhe gjendjen e tyre. Çdo institucion i cili nuk do t'i respektojë obligimet ndaj tij do të merren masa.

"Epoka e re": Janë të nevojshme të gjitha këto universitete publike dhe kolegjet private?

Bytyqi: Që në fillim kemi thënë se numri i universiteteve publike është e madh dhe nuk është e nevojshme që Kosova me më pak se dy milionë banorë të ketë kaq shumë universitete. Për këtë arsye kemi ngritur një grup profesional i cili ka bërë një fizibilitet të universiteteve publike dhe ka dalë me dy rekomandime për të cilat presim reflektim të Qeverisë dhe Kuvendit. Rekomandohet reduktimi i universiteteve publike në dy, pastaj universitetet e tjera të jenë degë e tyre ose të profilizohen universitetet. Më brengosës se numri i universiteteve është përmbajtja e tyre dhe e kolegjeve. Shumica e universiteteve dhe kolegjeve bazament e kanë Fakultetin Ekonomik dhe Juridik e që, në fakt, sipas statistikave, aktualisht Kosova ka më së paku nevojë për ekonomistë dhe juristë. Edhe për dhjetë vjetet e ardhshëm nuk kemi nevojë për juristë dhe ekonomistë. Kjo do të thotë se nuk jemi në balancë me kërkesat e tregut. Universitetet dhe kolegjet duhet të shohin se çfarë programesh janë të nevojshme për vitet e ardhshme dhe të rinjtë të marrin një diplomë me vlerë dhe të jenë të gatshëm për tregun e punës. Këtu duhet të jetë fokusi.

Do të ndërtojmë një strategji për arsimin e lartë

"Epoka e re": Z. Bytyqi, cilat do të jenë prioritetet e juaja gjatë këtij viti?

Bytyqi: Për pjesën parauniversitare i kemi identifikuar katër shtylla kryesore të cilat do të jenë bazamenti për ta ndryshuar gjendjen e cilësisë. Në shtyllën e parë është çështja e mësimdhënies dhe trajnimit të mësimdhënësve, pra ndryshimi i metodës së mësimdhënies nga metoda klasike në metodën moderne. Këtë do ta arrijmë me forma të reja të trajtimit të mësimdhënësve dhe jo siç ka qenë deri më tash me një trajnim të përgjithshëm. Në shtyllën e dytë kemi qeverisjen e shkollave dhe kemi konstatuar se kemi një qeverisje jo të duhur. Gardiani i mbrojtjes së cilësisë në shkollë është drejtori që duhet të jetë menaxher i mirë. Do ta kemi një formë tjetër të zgjedhjes së drejtorëve të shkollave. Faktor kyç në zgjedhjen e tyre do të jenë prindërit. Me këtë formë do t'i eliminojmë ndikimet e jashtme

dhe politizimin e shkollave. Do të kemi edhe një formë tjetër të zgjedhjes së mësimdhënësve. Jemi në diskutim të modelit të Shqipërisë që është model shumë i mirë ku pas përfundimit të Fakultetit të Edukimit dhe apo fakulteteve të tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënien e futen një testi online dhe bëhet një renditje nga më të mirët. Pastaj kudo që hapet një konkurs personi që është në renditje i pari e ka vendin e garantuar. Në shtyllën e tretë është monitorimi i shkollave që është një formë e re, ku një rol kyç do ta luajë inspektorati i arsimit. Me metodën e re do të kemi inspektorë këshillëdhënës dhe pastaj pjesa e dytë do të jetë matja e performancës dhe inspektimi në orë. Kjo metodë do ta rrisë cilësinë e arsimit në shkolla. Shtylla e katërt ka të bëjë me rritjen e aktorëve nëpër shkolla. Prindërit do ta kenë një rol më aktiv nëpër shkolla, por edhe aktorët e tjerë të ministrive të linjës sepse kemi shumë

dukuri negative në shkolla siç është dhuna dhe përdorimi i narkotikëve. 2018-ta ka qenë alarmante sa i përket përdorimit të narkotikëve dhe nuk mund të rrimë indiferentë kundër këtyre problemeve, por duhet të marrim masa. Synojmë t'i eliminojmë apo t'i minimizojmë këto dukuri. Këto do të jenë katër shtyllat si fokus i prioritetit për këtë vit. Me GIZ-in gjerman synojmë t'i ndërtojmë 10 shkolla në të cilat do të implementohen këto katër shtylla, pastaj ato të merren model nga të tjerët. Kurse te pjesa e arsimit të lartë kemi një grup profesional të krijuar nga USAID-i me ekspertë ku do të marrim informacione për gjendjen e përgjithshme të sistemit të lartë arsimor dhe do të identifikohen dobësitë që nga qeverisja brenda institucioneve e deri te programet që kanë nevojë institucionet e arsimit të lartë. Do të ndërtojmë një strategji për arsimin e lartë me qëllim të rritjes së cilësisë së arsimit.

SBASHK-un dhe të tjerët në mënyrë që të mbrohen mësimdhënësit karshi renditjes së koeficientit në listën e pagave. Nuk do të ketë ulje të pagave të mësimdhënësve, por po tentojmë të trajtohen në renditje me profesionet e tjera sepse jemi të interesuar që sistemi arsimor të jetë në një nivel tjetër. Me koeficientët e fundit finalë kemi rritje të pagave për mësimdhënësit e arsimit të lartë, por jo edhe në arsimin fillor. Prandaj po tentojmë që edhe në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët të kemi rritje të pagave, mirëpo edhe pjesa e arsimit të lartë të ketë rritje më të lartë sesa që është aktualisht në projektligj.

"Epoka e re": Në vazhdimësi thuhet se arsimi është prioritet kombëtar, megjithatë në vitet e fundit ka rënë cilësia në arsim. Çfarë do të bëni konkretisht për ta rritur cilësinë?

Bytyqi: Gjendja në sistemin arsimor



189 raste, për 24 orë në Emergjencë

PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë trajtuar 189 raste për 24 orë. 35 pacientë kanë marrë shërbimet e nevojshme mjekësore në dhomën e reanimimit, 44 persona u janë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjike. Gjatë

kësaj kohe kishte edhe 67 raste internistike dhe 27 ortopedike. Si pasojë e aksidenteve në trafik, tetë persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Për trajtim të mëtutjeshëm në klinikat e QKUK-së janë pranuar 34 pacientë. Ndërkaq gjatë 24 orëve të fundit në Klinikën e

Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kishte 34 lindje. Sipas të dhënave të kësaj klinike, 21 foshnja janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 15 i përkasin gjinisë femërore. Dy nëna lindën binjakë, 14 lindje u realizuan me operim, gjersa 12 gra u bënë nëna për herë të parë.

KDI dhe OJQ-të kërkojnë nga gjashtë komunitat ndëshkim për mospërbushje të rekomandimeve të auditorit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 JANAR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe OJQ-të partnere YAHR, ISDY, Syri i Vizionit dhe Ekovizioni, në partneritet me USAID-in, në kuadër të aktivitetit për komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse, përmes një konference për media, kanë shpallur të mërkurën të gjeturat kryesore të raportit "Menaxhimi i parasë publike në sytë e Auditorit të Përgjithshëm".

Ky raport analitik pasqyron rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm lidhur me menaxhimin e parasë publike. Raporti, gjithashtu, analizon edhe implementimin e rekomandimeve të auditorit nga gjashtë komunitat vijuese: Prizren, Suharekë, Ferizaj, Lipjan, Podujevë dhe Istog për vitin 2017.

Diana Metushi Krasniqi nga KDI-ja ka theksuar se OJQ-të partnere kanë studiuar raportet e auditorit nga perspektiva e menaxhimit të parasë publike, me fokus në të gjeturat që lidhen me prokurimin publik. Ajo ka thënë se edhe pse jo të gjitha gjetjet e auditorit janë të kualifikueshme që të hetohen nga prokuroria, është e nevojshme të instalohen mekanizma të cilët sigurojnë zbatimin e rekomandimeve qoftë si masa disiplinore apo masa administrative. "Në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)



janë një numër i gjetjeve të cilat përsëriten nga viti në vit, e që shpërfaqin problemet lidhur me planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit, menaxhimin e subvencioneve, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, procedurat e prokurimit dhe faturimin apo pagesat për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale", ka thënë Krasniqi. Bekim Krasniqi nga Organizata YAHR ka pohuar se raportet e auditorit për periudhën 2015-2017 për komunën e Ferizajt theksojnë dobësi në qeverisje në raport me llogaridhënie,

menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Këto gjetje, të cilat vazhdojnë të përsëriten në të gjitha raportet e ZKA që nga viti 2015, tregojnë për probleme sistematike përdorimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake vazhdon të jetë i ulët. Gjetjet sistematike potencojnë dobësi në kontrollin menaxherial dhe menaxhimin e rrezikut, moskryerje të obligimeve (qirasë) nga shfrytëzuesit e pronës komunale, moskryerje të obligimeve (taksës) nga bizneset, mospërdorim të E-pasurisë dhe

mungesë të depoz. Erolina Morina nga organizata ISDY ka theksuar se raportet e auditorit për Komunën e Prizrenit për periudhën 2015-2017 reflektojnë dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale, lidhjen e kontratave publike jashtë planit vjetor të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe kosto shtesë dhe sfida buxhetore për komunën si rezultat i planifikimit jo të saktë të projekteve. Shpend Sopa nga organizata Ekovizioni ka thënë se ekzistojnë

disa mangësi sa i përket qeverisjes brenda Komunës së Podujevës, veçanërisht në lidhje me moszbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, realizimin e buxhetit dhe kontratave të nënshkruara në mungesë të buxhetit, ndarja e prokurimeve dhe përdorimi i procedurave minimale, si dhe iniciativa modeste për mbledhjen e të hyrave. Koalicioni i organizatave për monitorimin e prokurimit publik u bënë thirrje komunave të fokusohen në përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

Qeveria do të jetë e fokusuar për përmbushjen e agjendës legislative për vitin 2019

PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin në vijim do të jetë realizimi i agjendës legislative për vitin 2019 dhe për realizim të saj është i nevojshëm një bashkëpunim dhe koordinim i punës së Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, kryeministri Haradinaj ka zhvilluar një takim të mërkurën me shefat e grupeve parlamentare nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK),

Memli Krasniqi, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) Ahmet Isufin dhe Bilall Sherifin nga Nisma, për të diskutuar për mundësitë e realizimit të agjendës legislative, që nënkupton edhe realizimin e projekteve tona për të ecur drejt një shoqërie të zhvilluar dhe të konsoliduar demokratike. Kosova ka nevojë për dinamikë të re të bashkërendimit të punëve Qeveri - Kuvend, me qëllim të realizimit të obligimeve institucionale në konsolidimin dhe

zhvillimin e shtetit tonë. Ky takim do të jetë në vazhdim të shtimit të punës sonë, për ta përmblytur agjendën legislative, që është edhe pjesë e detyrimeve tona në procesin e integritetit euroatlantike. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë me përkushtim bashkëpunimin me të gjithë aktorët shtetërorë dhe institucionale, me qëllim të arritjes së objektivave qeverisëse të vendit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.



OVLUÇK-ja: Gjykata Speciale, e njëanshme



Kryesia e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), në mbledhjen e mbajtur të mërkurën, ka vlerësuar se Gjykata Speciale është një e padrejtë që i ka ardhur Kosovës, sepse është e njëanshme dhe nuk i gjykon krimet e shkaktuara nga Serbia pushtuese

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 JANAR - Kryesia e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka mbajtur të mërkurën mbledhje në të cilën është diskutuar rreth Gjykatës Speciale. "Kryesia e OVLUÇK-së ka ritheksuar se Gjykata Speciale është një e padrejtë që i ka ardhur Kosovës sepse është e njëanshme dhe nuk i gjykon krimet e shkaktuara nga Serbia pushtuese, pasi që shumë vjet që nga paslufta ishim dëshmitarë të dështimit total të drejtësisë ndërkombëtare e cila nëpërmjet mekanizmave të ashtuquajtur të drejtësisë vazhdimisht organizoi komplete kundër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", është thënë në komunikatën për media të OVLUÇK-së.

Kryesia e OVLUÇK-së në këtë mbledhje ka theksuar se vazhdimisht ka kërkuar që të krijohet gjykatë speciale vendore. "Ne si OVLUÇK kemi kërkuar vazhdimisht të krijohet Gjykatë Speciale vendore e cila do t'i ndiqte të gjitha krimet që janë shkaktuar në Kosovë, sepse përsëri e themi se nuk jemi kundër drejtësisë, por konsiderojmë se nuk po ndiqen krimet. OVLUÇK-ja do ta përcjellë me vëmendje situatën dhe reagimet do t'i bëjë në përputhje me zhvillimet", është thënë në komunikatën e OVLUÇK-së. Liderët e institucioneve të vendit në këtë fillimvit kanë theksuar se Gjykata Speciale do të jetë një sfidë për Kosovën. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka ftuar bashkëluftëtarët t'u përgjigjen thirrjeve të Dhomave të Specializuara sepse, sipas Veselit, sado e padrejtë të jetë

kjo gjykatë, primar duhet të jetë interesi kombëtar i shtetit tonë. "Gjykata Speciale do të jetë një sfidë nga e cila Kosova do të dalë edhe më e fuqishme. Nga kjo sfidë edhe më e fuqishme do të dalë lufta e drejtë dhe e shenjtë e UÇK-së. Sfidat janë procese që nuk e ndalin Kosovën. Ne do ta vazhdojmë rrugëtimin tonë, do t'i përgjigjemi kësaj sfide. Ftoj të gjithë bashkëluftëtarët t'u përgjigjen thirrjeve të Dhomave të Specializuara. Sado e padrejtë kjo Gjykatë, sado sfiduese, ne duhet ta kemi çdoherë primar interesin kombëtar të shtetit tonë", ka deklaruar Veseli për gazetën "Epoka e re". Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se ky vit nuk do të jetë i lehtë për Kosovën për shkak të sfidës së dialogut me Serbinë dhe Gjykatës Speciale, por ai ka bërë me dije se do t'i përkrahë të gjithë ata që do të përballen me këtë gjykatë. Sipas Haradinajt, nuk duhet të ndodhë që ndonjë ish-pjesëtar i UÇK-së të bëjë ndonjë veprim të pahijshëm dhe të pandershëm për Kosovën. "Viti 2019 do të jetë një vit i rëndë, sepse do të jenë edhe implikimet e Gjykatës Speciale. Qëllimi im është ta ruajmë Kosovën. Nuk

do të kërkoj zgjedhje. Do ta kërkoj vetëm konsolidimin e Kosovës. Po ashtu, jam i interesuar t'i ruaj ish-pjesëtarët e UÇK-së, pra t'i përkrah të gjitha ata që përballen me këtë sfidë. Ne duhet ta nderojmë veten edhe para drejtësisë, duke mos u turpëruar. Nuk duhet të ndodhë që ndonjë ish-pjesëtar i UÇK-së të bëjë ndonjë veprim të pahijshëm dhe të pandershëm për Kosovën", ka deklaruar Haradinaj për gazetën "Epoka e re". Edhe avokati Tomë Gashi ka thënë se do të jetë sfidues për Kosovën ballafaqimi me Gjykatën Speciale. Ai ka theksuar se e vetmja e mirë që tani mund të bëjë shteti i Kosovës është që ta rrisë fondin për mbrojtjen e atyre që do të akuzohen nga Gjykata Speciale. Sipas tij, është tepër e vogël, për të mos thënë qesharake, shuma prej një milion e 500 mijë eurosh që është ndarë për të akuzuarit, avokatët, familjet e të akuzuarve dhe për dëshmitarët. "Kosovës si shtet i pavarur askush nuk ia ndalon ta rrisë fondin për mbrojtjen e të akuzuarve në Gjykatën Speciale që të mund të formohen ekipet më të mira të avokatëve në mënyrë që të ofrohet mbrojtja sa më efektive

juridike që mundësisht asnjë prej ish-pjesëtarëve të UÇK-së të mos gjendet fajtor për veprat morbide të cilat i përmend raporti i senatorit Dick Marty", ka thënë Gashi për gazetën "Epoka e re". Avokati Gashi ka thënë se Gjykata Speciale, përkatësisht Zyra e Prokurorit Special, ka filluar punën dhe tashmë disa të dyshuar janë ftuar të japin deklaratat, e disa prej tyre veçse i kanë dhënë deklaratat në dhjetor të vitit 2018. Gashi ka paralajmëruar se akuzat e para do të ngrehën në pjesën e parë të këtij viti por, sipas tij, askush nuk e di se kush do të akuzohet. "Ky është vetëm fillimi dhe askush nuk duhet të mendojë se Gjykata Speciale do të merret me 7 apo 8 persona që i ka ftuar deri më tani. Ende nuk kemi raste të gjykimit, nuk kemi as raste të akuzave, por këto me siguri se do të ndodhin gjatë këtij viti. Akuzat e para me siguri se do të ngrehën në pjesën e parë të këtij viti, por askush nuk e di se kush do të akuzohet. Aktualisht kemi vetëm persona të dyshuar", është shprehur Gashi, duke shtuar se Gjykata Speciale do të merret me periudhën prej 18 muajve gjatë luftës dhe 18 muajve pas luftës.

Vehbi Imeri i bashkohet AAK-së

PRISHTINË, 9 JANAR - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka bërë me dije të mërkurën se kësaj partie i është bashkuar doktori i shkencave të

ekonomisë, Vehbi Imeri. "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, parti e vlerave dhe me vizion të qartë zhvillimor, i hapi dyert edhe një profesionisti nga fusha e ekonomisë. Doktorin e shkencave, Vehbi Imerin, e falënderova për besimin e

shprehur për t'iu bashkuar familjes së Aleancës. Duke qenë se Qeveria ka fokusuar tërë energjinë e saj në ekonomi, e mirëpritur gatiqshëm të dr. Imerit për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit", ka shkruar Haradinaj.



Haradinaj: Dogana, një nga institucionet më të besueshme në vend

PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ministri i Financave, Bedri Hamza, kanë vizituar të mërkurën Doganën e Kosovës, ku janë pritur në takim nga drejtori i këtij institucioni, Bahri Berisha. Me këtë rast, Haradinaj ka lavdëruar punën e Doganës së Kosovës, duke thënë se është një nga institucionet më të besueshme në vend. "Një nga institucionet më kredibile të akumulimit të të hyrave shtetërore, me rreth 65 për qind të buxhetit në total, dhe mekanizëm që ndërlihd tërë tregtinë e vendit, Dogana e

Kosovës, me përgjegjësi të shtuar po e kryen misionin e vet kushtetues dhe ligjor. Sot, në takim pune, së bashku me ministrin Bedri Hamza, drejtorin Bahri Berisha dhe zyrtarët e tjerë doganorë biseduam për dinamizimin dhe modernizimin e vazhdueshëm të Doganës. Qeveria e vendit do ta mbështesë Doganën e Kosovës, që t'u përgjigjet sfidave të reja, mbrojtjes së ekonomisë si komponentë e rëndësishme e sigurisë nacionale, përfshirë luftimin e evazionit fiskal dhe informalitetit", ka thënë Haradinaj pas takimit.



KEK-u implementon shërbimet e fundit teknologjike të VALA-s



PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Telekom i Kosovës dhe Korporata Energjetike e Kosovës kanë finalizuar të mërkurën edhe një tjetër kontratë të re komerciale. Bëhet fjalë për implementimin dhe automatizimin për herë të parë të ndërlihdjeve me fije optike të objekteve strategjike si termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" si dhe shumica e nënstacioneve energjetike të kësaj korporate. "Të kesh një ndërmarrje të madhe siç është KEK-u që, përveç faktit se ka përfshirë të gjithë punonjësit e vet në VALA kohë më parë, e tani i beson teknikisht edhe rrjetit tonë të shpejtë të internetit që i nevojitet për operimin e sistemeve operacionale të termocentraleve, tregon më së miri se Telekom i është garantues dhe mbështetës i shërbimeve të sigurta, të duhura dhe të avancuara për çdo konsumator individual dhe biznesor", ka thënë ushtruesi i detyrës së

kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi. Thellimi i bashkëpunimit dhe nënshkrimi edhe i një kontrate tjetër mes këtyre dy ndërmarrjeve është shembulli më i qartë i mirëbesimit të vazhdueshëm mes dy gjigantëve të ekonomisë së Kosovës. "Duke ditur specifikat dhe kompleksitetin e punës që bëhet në korporatën tonë, bashkëpunimi me VALA-n është po kaq i domosdoshëm dhe lehtësues për mbarëvajtjet dhe punëve tona teknologjike, sidomos për mirëmbajtjen e sistemeve operative të termocentraleve tona", ka thënë Njazi Thaqi, drejtori menaxhues i KEK-ut. Kjo është marrëveshja e dytë radhazi midis këtyre dy ndërmarrjeve më të mëdha publike në vend, pasi që muaj më parë rreth 5 000 punëtorë të KEK-ut i janë bashkëngjitur VALA-s pas kalimit nga konkurrenca.

Ministria e Bujqësisë dhe Shoqata 'Gen Vet' nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Shoqata për Përmirësimin Racor të Gjedheve "Gen Vet" kanë nënshkruar të mërkurën një memorandum mirëkuptimi përmes të cilit synohet mbështetja dhe promovimi i aktiviteteve të shoqatës në sektorin e blegtorisë. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të këtij memorandum, ministri i MBPZHR-së, Nenad Rikalo, tregoi se mbështetja e ministrisë për avancimin e veprimtarisë së shoqatës do të rritet në vazhdimësi. "Ky memorandum ka rëndësi të veçantë për Shoqatën 'Gen Vet' pasi që përmes kësaj forme të bashkëpunimit po krijohen mundësitë që shoqata t'i

shfrytëzojë asetet e ministrisë për zhvillimin dhe avancimin e aktiviteteve të saj e bashkë me këtë ta promovojë zhvillimin e prodhimtarisë blegtoriale dhe riprodhimin e bagëtisë në gjithë vendin", ka thënë ministri Rikalo. Krahas kësaj, ministri ka theksuar se ky memorandum mirëkuptimi, i cili është nënshkruar për një periudhë dyvjeçare, do të ndihmojë shoqatën që aktivitetet e saj në sektorin e blegtorisë t'i zhvillohen sipas praktikave më të mira, por që krahas kësaj ai tha se ministria përmes formave të ndryshme do të ofrojë mbështetje për veprimtaritë e shoqatës. Përmes këtij memorandum i mundësohet Shoqatës "Gen Vet" që t'i shfrytëzojë asetet e min-



istritë, në veçanti të Qendrës Gjenetike në Vitomeriçë të Pejës, duke përfshirë këtu edhe asetet e

siguruara nga MBPZHR-ja, nga Qeveria e Italisë nëpërmjet Programit për Bashkëpunim

Ndërkombëtar dhe tokën që i takon Institutit Bujqësor të Kosovës me seli në Pejë.

Minatorët kërkojnë rritje të pagave, gjendja financiare në 'Trepçë' jo e mirë



Minatorët e "Trepçës" kanë vazhduar grevën edhe ditën e mërkurë me kërkesën që t'u rriten pagat dhe të shkarkohen bordi dhe menaxhmenti i kësaj ndërmarrje. Mirëpo kërkesat e tyre janë quajtur të paarsyeshme duke parë gjendjen financiare të "Trepçës"

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 JANAR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, dhe kryetari i Komunitetit të Mitrovicës, Agim Bahtiri, janë takuar të mërkurë me këshillin grevist të minatorëve, por ky takim rreth dy orësh ka rezultuar pa marrëveshje. Minatorët, të cilët kanë hyrë në grevë që nga 3 janari, tashmë kanë reduktuar kërkesat në dy sosh: Rritjen e pagave për 20 për qind dhe shkarkimin e bordit dhe të menaxhmentit të ndërmarrjes "Trepça". Lidhur me këtë situatë të krijuar kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, ka thënë se çështja e "Trepçës" është neglizhuar nga spektri politik, për të cilën gjë ajo i ka

bërë thirrje opozitës të unifikohen dhe ta kalojnë draftstatusin e kësaj ndërmarrje në Kuvendin e Kosovës. Me këtë veprim ajo ka thënë se do t'i hapet rrugë zhvillimit ekonomik të "Trepçës".

Sala Berisha-Shala ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mungesa e vullnetit politik të opozitës për t'u unifikuar, për të cilën gjë ka përmendur edhe mbledhjen e 14 nëntorit të komisionit të cilën ajo e drejton, e që ajo mbledhje ka dështuar në mungesë të kuorumit, ku u pamundësua edhe raportimi i kryesuesit të bordit të kësaj ndërmarrje, Ardian Sylja. "Deri më tani ka munguar vullneti politik dhe, siç e dini, në mbledhjen që kam ftuar për të raportuar për gjendjen e 'Trepçës' nuk kishte kuorum të mjaftueshëm, pasi opozita nuk

erdhi në mbledhje. Unë do të përpiqem që me deputetë të pozitës ta bëjmë kuorumin dhe ta çojmë përpara këtë çështje. Në mbledhjen e 14 nëntorit na u pamundësua të diskutojmë dhe ta shohim se si është gjendja me 'Trepçën' pasi nuk kishte kuorum dhe kryesuesit të bordit z. Sylja iu pamundësua raportimi. Prandaj kemi pakënaqësi dhe greva të punëtorëve", ka thënë Shala. Ajo e ka quajtur të paarsyeshme grevën e minatorëve të cilët fillimisht kishin kërkesa për rritjen e pagave për 20 për qind, për dhënien e 100 eurove dhe nga një dhuratë për minatorët, si dhe ndaljen e punësimeve pa konkurs.

Berisha-Shala ka thënë se bazuar në gjendjen aktuale të "Trepçës" dhe pamundësimin për të operuar me fitim, janë të paarsyeshme kërkesat e minatorëve.

Kurse sa i përket bordit dhe menaxhmentit, ajo ka thënë se kjo nuk është kompetencë e tyre. "Nuk duhet të ndikohen minatorët nga politika dhe opozita. Sipas mendimit tim, nuk mund të ketë rritje të pagave në një ndërmarrje ku operohet me humbje, ndërkaq

sa i përket kërkesës për shkarkim të bordit dhe menaxhmentit, kjo është kompetencë e Qeverisë dhe e Kuvendit. Ta kemi parasysh se bordi ende nuk është kompletuar dhe nuk ka pasur mundësi dhe rrugë që të punojë më mirë. Kjo dihet që ndodhi për shkaqe politike, pasi u pamundësua puna e mirëfilltë e këtij bordi", është shprehur Berisha Shala. Ajo ka thënë se pas miratimit të draftstatusit dhe rimëkëmbjes së "Trepçës" atëherë mund të kërkohej rritja e pagave. Ndërkaq ushtruesi i detyrës së menaxherit në ndërmarrjen "Trepça", Xhevdet Tahiri, ka bërë një rezymë të gjendjes financiare të ndërmarrjes "Trepça". Ai, po ashtu, ka reaguar edhe për grevën e minatorëve, për të cilën ka dhënë edhe vlerësimin e tij.

Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se do të ndihet i privilegjuar po të kishte mundësi të rritjes së pagave prej 20 për qindësh ashtu siç janë duke kërkuar minatorët por, sipas tij, gjendja financiare në "Trepçë" dhe detyrimet nga e kaluara e pamundësojnë një gjë të tillë. "Me ardhjen time si u. d. menaxher i ndërmarrjes 'Trepça', situata financiare dhe

operative e ndërmarrjes 'Trepça' ishte në një kaos të madh. Borxhet e trashëguara ndaj operatorëve ekonomikë ishin rreth 650 mijë euro, obligimet e grumbulluara me vite ndaj KEK-ut ishin në vlerë 1,649,370.00 euro. Edhe përkundër obligimeve të larta të trashëguara nga menaxhmentet paraprake, unë kam arritur ta drejtoj ndërmarrjen drejt rimëkëmbjes. Edhe pse vetëm një muaj të plotë jam në krye të ndërmarrjes, kemi arritur ta ngrahim produktivitetin në ndërmarrje, duke ngritur disiplinën dhe vijueshmërinë në punë", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se gjatë këtij muaji sa është në krye të ndërmarrjes, me një riorganizim të ri ka rritur prodhimin mbi 9.27 për qind, duke i reduktuar shpenzimet operative të ndërmarrjes rreth 4.2 për qind.

Tahiri ka thënë se sa i përket grevës së minatorëve e cila po vazhdon që dhjetë ditë tanimë, sipas tij, kjo grevë është e orkestruar nga qarqet politike brenda dhe jashtë "Trepçës". Sipas tij, këto qarqe politike nuk e dëshirojnë një "Trepçë" të zhvilluar me një bilanc pozitiv dhe me minatorë të dinjitetshëm.

Muharremaj: Do të investojmë në të gjithë fshatrat e Suharekës

SUHAREKË, 9 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, është zotuar se do të angazhohet për gjetjen e mundësive për investime në të gjithë fshatrat e kësaj komune. Ai u ka thënë banorëve të fshatit Nishor se është i përkushtuar në punë dhe se do ta mbajë fjalën e dhënë. "Angazhimi im do të jetë i vazhdueshëm për gjetjen e mundësive për investime në të gjitha fshatrat e Komunës së Suharekës. Sot u takova me banorët e fshatit Nishor për të diskutuar mbi investimet e ardhshme që ka nevojë dhe për rregullimin e infrastrukturës në shumë sektorë. Jam i përkushtuar në punë dhe do ta mbaj fjalën", ka thënë Muharremaj pas këtij takimi me banorët e fshatit Nishor.



Pastrimi i rrugëve kryesore të kryeqytetit, prioritet i Komunës së Prishtinës

PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se kompanitë e kontaktuar nga kjo komunë janë duke punuar me kapacitete të plota për pastrimin e rrugëve nga bora. Ai ka thënë se prioritet i

komunës mbeten rrugët kryesore të kryeqytetit dhe vendbanimet e bllokuara. "Të gjitha kompanitë e kontraktuara kanë qenë tërë natën në terren dhe vazhdojnë të punojnë me kapacitete të plota. Reshjet pritet të vazhdojnë, prandaj lusim për qarkullim të

kufizuar dhe përshtatje të shpejtësisë. Me prioritet janë arteriet kryesore dhe vendbanimet e bllokuara. Për çdo emergjencë lajmërohuni në Qendrën e Thirrjeve 038 245 666 dhe 038 245 777", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari Jashari: Policia, institucioni më i besueshëm



SKENDERAJ, 9 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, dhe nënkryetari Nuredin Lushtaku, kanë marrë pjesë në takimin e përvitshëm të organizuar nga Stacioni Policor në Skenderaj, ku është paraqitur raporti vjetor i punës së policisë. Jashari e ka lavdëruar punën e Policisë së Kosovës, duke e quajtur institucionin më të besueshëm në Kosovë. "Policia e Kosovës mbetet institucioni më kredibil në Kosovë. Pjesëtarët e saj me punën fisnike, duke sakrifikuar edhe jetën, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në shërbim të qytetarëve, ruajtjes së rendit dhe

sigurisë publike. E vlerësoj pa fund angazhimin e secilit zyrtar policor, që me profesionalizëm në detyrë na ofrojnë më shumë siguri", është shprehur Jashari. Ai ka thënë se është i gatshëm të bashkëpunojë me policinë kurdo që kërkohet. "E ritheksova gatishmërinë time si kryetar i komunës, për të bashkëpunuar shumë ngushtë kurdo që kërkohet dhe në çdo kohë, në funksion të rendit dhe sigurisë publike. Falënderoj komandantin e Stacionit Policor në Skenderaj, toger Bastri Durmishi, për bashkëpunimin e mirë që kemi në vazhdimësi! Përgëzime për Policinë e Kosovës!", ka thënë Jashari.

'Pastrimi' në Drenas: Do të këtë vështirësi të bartjes së mbeturinave për shkak të borës

DRENAS, 9 JANAR (ER) - Kompania "Pastrimi" në Drenas ka njoftuar të gjithë qytetarët e kësaj komune se për shkak të reshurave të pandërprera të borës do të këtë vështirësi gjatë itinerarit të bartjes së mbeturinave, e sidomos në pjesët rurale, gjegjësisht në fshatrat malore. Me këtë rast, kjo kompani ka kërkuar mirëkuptim nga të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Po ashtu, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe e Emergjencës në Drenas ka njoftuar të gjithë qytetarët se

dy kompanitë e kontraktuara për pastrimin e rrugëve janë në terren. Drejtoresha e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapit, e shoqëruar edhe nga menaxheri i projektit, që nga mëngjesi i së mërkurës kanë dalë në terren për ta verifikuar gjendjen e rrugëve të Komunës së Drenasit. Sipas Krapit, rrugët në këtë komunë janë të kalueshme, por me vështirësi. Ajo ka ftuar të gjithë qytetarët të jenë bashkëpunues gjatë këtyre ditëve.



Narkoza e vizave - mit apo realitet (13)



Shkruan: Agron HOTI

Politika jonë

Përbërja politike e Kosovës prej viteve '90 e deri më sot nuk ka përjetuar ndonjë ndryshim të madh rrotativ. Marrë së bashku lëvizjen paqësore, luftën dhe situatën e pasluftës, nuk është se ka pasur ndonjë ndryshim të madh. Dhe kjo politikë me të gjitha përparësitë dhe të metat ka qenë pjesë e të gjitha proceseve prej viteve '90 e deri më sot. Është pikërisht kjo bashkësi ndërkombëtare që vazhdimisht na përsërit refrenin që Kosova dhe shtetet e rajonit janë të kapura nga politikanë të fuqishëm.

Në njërin anë BE-ja përsërit refrenin, në anën tjetër bashkëpunon ngushtë me këtë politikë jo vetëm të Kosovës, por edhe të tërë rajonit. Kjo vazhdimisht ka shkakuar dhe shkakton konfuzion te qytetarët e Kosovës se kë duhet votuar dhe kë jo. Nëse bashkësisë ndërkombëtare kjo politikë e Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor i është dashur për hir të legjitimitetit të proceseve të rënda nëpër të cilat kemi kaluar, atëherë edhe qytetarët kanë votuar konform kalkulimeve, sepse qytetarët e Kosovës janë shumë të orientuar nga veprimet e bashkësisë ndërkombëtare dhe se qasja e kësaj të fundit ka ndikim të madh në orientimin e votës në Kosovë.

Fundja qytetarët e Kosovës nuk kanë mundur të nxjerrin qeverisje suedeze apo finlandeze me mentalitet ballkanik, sepse një gjë e tillë askund në botë nuk ka mundur të ndodhë e as që mund të ndodhë. Nuk do mend që bashkësia ndërkombëtare ka vepruar sipas motos "qysh është vendi bëhet kuvendi", por nëse ky ka qenë qëllimi është dashur të thuhet së paku për hir të qytetarëve të Kosovës. Sepse qytetarët kanë besuar në procesin e përbërë nga lëvizja paqësore, luftë çlirimtare, pavarësimi dhe shtet-ndërtimi. E të gjitha këto procese u drejtuan nga kjo politikë vendore kush më shumë e kush më pak.

Nuk ka kualifikim më të rëndë se sa të thuhet "rajoni i Ballkanit Perëndimor është duke vuajtur nga kapja e shteteve nga politikanë të fuqishëm". Por, nëse BE e di saktë që kjo është e vërtetë, atëherë pse nuk

ndërmerr masa sanksionuese, p.sh. duke ndërprerë fondet për Kosovën ose siç bën SHBA me listën e zezë?!

Masat sanksionuese nuk janë të pamundshme, prandaj, nëse vërtet gjendja është e tillë, atëherë ato duhet vënë në veprim. Ç'është e vërteta masa sanksionuese nuk janë ndër-marrë asnjëherë nga BE ndaj asnjë shteti, madje fondet për Kosovë e rajon janë duke u rritur, me po këta njerëz në krye të shteteve. E në Kosovë, për dallim prej rajonit, BE e kishte dhe e ka ende instrumentin ligjor që është EULEX-i, përmes të cilit do të mund të hetoheshin, arrestoheshin dhe burgosej çdokush.

E Mali i Zi ka në pushtet të njëjtën elitë politike që para disa viteve i sillte BE-së dëme euro-miliardëshe në kontrabandën me cigare, sidomos Italisë, dhe tash na del që Mali i Zi i prirë nga kjo elitë të jetë "frontrunner" i procesit të integritimit evropian në rajon. Pra, nëse edhe Mali i Zi bën pjesë në vendet që nga BE po quhen "shtete të kapura nga elitat e korruptuara dhe kriminalizuara", atëherë si ka mundësi që kjo elitë në fakt dëmtuese e BE-së të jetë prijëse e frontit në rajon?! Para disa viteve kjo elitë bënte veprime të rënda kriminale, kurse sot veprime demokratike, a mundet kush t'i bie në fije?!

Pastaj, së fundi ndodhi që ish-Kryeministri i Maqedonisë, Gruevski, të dënohet nga gjykata maqedonase dhe të mos futet në burg menjëherë, mundësi kjo e krijuar që Gruevski të kërkojë azil në Hungari, në një vend të BE-së, ku ne si qytetarë të Kosovës po shpresojmë të anëtarësohemi. Në anën tjetër, shteti maqedonas, përpos që nuk ka pasur vullnet për ta zbatuar vendimin e gjykatës, nuk ka lëshuar kurrfarë arresti

ndërkombëtar.

Në aspektin politik kjo ikje mund të interpretohet se sa më larg Gruevski aq më lehtë kalonë ndryshimet kushtetuese për ndryshimin e emrit të Maqedonisë, diçka që Gruevski e kundërshtonte me çdo mjet duke pasur ndikim në struktura të caktuara të cilat do të mund ta destabilizonin vendin. Se a kalkuloi këtu qeveria maqedonase apo qëllimshëm nuk desh të veprojë mbetet për t'u diskutuar, por ajo çfarë i intereson qytetarit këtu është se ku mbeti Sundimi i Ligjit në Maqedoni?! Ndërkohë, Gruevski qëndron në zemër të BE-së, pra në Hungari, në një shtet që parimisht do të ishte dashur ta ekstradonte atë menjëherë në Maqedoni. Pra, keq Maqedonia keq Hungaria, keq BE. Pra, si ta gjejë rrugën e duhur qytetari i Kosovës?!

Serbinë e udhëheq një njeri që publikisht kishte kërkuar vrasjen e myslimanëve në Bosnje e Hercegovinë, një njeri që kishte qenë pjesë integrale e aparatit shtetëror serb që bëri gjenocid ndaj boshnjakëve dhe shqiptarëve. Ky njeri që quhet Vuçiq, ashtu sikurse atëherë, por sot me mjete tjera, i bën obstrukcione Bosnjës e Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë, të gjitha këto në favor të shtetit serb dhe në dëm të rajonit dhe Evropës.

Për t'iu kthyer prapë politikës së Kosovës, vlen të theksohet se është pikërisht kjo politikë që, herë më shumë e herë më pak merr pjesë në procese dhe ngjarje nga më të rëndësishmet ndërkombëtare, është pikërisht kjo politikë që në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare ka përgatitur terrenin për pavarësinë e Kosovës, ka nënshkruar dhe nënshkruar përditë e më shumë marrëveshje ndërkombëtare (përfshirë ato financiare)

me shtete e mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë.

Dhe nëse një gjë e tillë është duke ndodhur, atëherë qytetarët nuk mund të jenë plotësisht indiferent ndaj politikës së tyre. Nëse BE ka vendosur të bashkëpunojë me politikën kosovare, të cilën në raporte të ndryshme po e quan "kapëse të shtetit", atëherë a mund të vendosin ndryshe qytetarët e Kosovës?! Madje mesatarja e mbështetjes së qeverive në vende të BE-së nuk është shumë më ndryshe se sa në vendet e Ballkanit, përfshirë edhe Kosovën.

Qytetarët natyrisht që s'munden sepse kanë parë dhe shohin këtë politikë të ketë marrë pjesë dhe të merr pjesë në ngjarje e manifestime nga më të mëdhatë botërore, të takohet me njerëz e qeveri nga më të fuqishmet në glob, atëherë ata sigurisht që i besojnë kësaj politike, sigurisht që rezervat i kanë për zhvillime të caktuara që është normale për opinionin publik. Ç'është e vërteta edhe qytetarët e Kosovës i besojnë kësaj politike sipas përqindjes së njëjtë që besojnë qytetarët e BE-së në qeveritë e tyre.

Trendi i besimit të qytetarëve ndaj lidërshipeve në botë është në rënie, sepse politika në botë kurrë nuk ka qenë me e 'demaskuar' karshi premtimeve që jep dhe ky 'demaskim' vetëm sa do të rritet. Turbo-shpejtësia e qarkullimit të informacionit përmes teknologjisë informative që ka kapluar globin, e ka bërë dhe ende do ta bëjë më të vështirë qeverisjen pa marrë parasysh se kush cilin shtet do ta qeverisë. Qarkullimi i shpejtë i informacionit anëmbanë globit vetëm sa do të rrisë pritjet e qytetarëve dhe sigurisht që presionet publike nëpër qeveri vetëm sa do të rriten. Kjo do të ndikojë në rritjen e trendëve që

qeveritë të mos i shkojnë mandati deri në fund.

Nëse procesi i liberalizimit të vizave tentohet të bllokohet me arsyetimin se shteti i Kosovës qenka i "kapur", atëherë kjo duhet thënë haptazi dhe në të njëjtën kohë duhet të shoqërohet me masa sanksionuese të BE-s, pra të ndërpriten financat, ose të reduktohen së paku me qëllim të qytetarët e Kosovës ta marrin mesazhin. Kur e dimë që BE në Kosovë ka edhe misionin e EULEX-it që si synim parësor kishte pastrimin e Kosovës nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, më konkretisht pastrimin dhe rrjedhimisht "ç'kapjen" e shtetit, atëherë secili qytetar me të drejtë pyet se pse ky mision i BE-së nuk veprroi?!

Nëse politika e Kosovës ishte më e fuqishme se sa UNMIK-u, OSBE, EULEX-i, KFOR-i, Gjykata e Hagës dhe krejt në fund Gjykata Speciale, atëherë BE duhet vetë-reflektuar, sepse diçka këtu nuk është duke funksionuar siç duhet. Nëse tërë këta mekanizma të fuqishëm ndërkombëtarë nuk patën mundësi ta pastronin Kosovën nga kjo politikë, atëherë shpjegimi i vetëm është që bashkësia ndërkombëtare në Kosovë, as edhe një herë të vetme nuk kishte për qëllim pastrimin e Kosovës nga korrupsioni.

Sepse bashkësia ndërkombëtare - gjithnjë nëse iu referohemi raporteve ndërkombëtare - korrupsionin e kishte dhe e ka prezent edhe sot nëpër vende të veta dhe se Kosova nuk ishte ajo që e kishte zbuluar atë. Për hir të së vërtetës, ka një perceptim të përgjithshëm se korrupsioni në Kosovë u mësua goxha mirë dhe duhet të kalojnë vite deri sa të ulet së paku me mesataren e vendeve të BE-së. Gjithsesi që nuk mund të mohohet perceptimi se politika e Kosovës dhe e rajonit është e korruptuar dhe se kjo do të përbëjë sfidë për zhvillimet e gjithëmbarshme në vitet që vijnë.

Prandaj, shpëtimi i vetëm i Kosovës dhe rajonit do të ishte rritja dhe përshpejtimi i investimeve të BE-së, sepse Kina, Turqia, Vendet e Gjirit dhe Rusia janë duke u treguar më efçente dhe më të shpejta në investimet e tyre në rajonin tonë. Madje do të duhej që së paku projektet e mëdha infrastrukturore (autostrada, hekurudha, energji) të merreshin përsipër nga BE-ja pasi që janë jashtëzakonisht të kushtueshme, ndërkohë që Kosova dhe rajoni do të përqendroheshin në projekte tjera që nxisin zhvillim ekonomik. (Vijon)

The Schengen
Visa Countries



May përjashton zgjedhjet e parakohshme për shkak të Brexit

LONDËR, 9 JANAR - "Britania e Madhe do të dalë nga BE-ja më 29 mars dhe unë dua që ju t'ia dilni me marrëveshjen e 'divorcit' të arritur me Brukselin në nëntor", theksoi kryeministria Theresa May para rifillimit të debatit në Brexit dhe para votim-

it të ratifikimit mbi marrëveshjen e propozuar nga qeveria më 15 janar. Kryeministria britanike Theresa May përjashtoi edhe zgjedhjet e parakohshme në rast të refuzimit më 15 janar nga Dhomenë e Komuneve të marrëveshjes mbi

Brexit, të arritur prej saj me Brukselin. "Qeveria nuk dëshiron zgjedhje, por një marrëveshje të mirë", tha ajo duke replikuar me liderin e laburistëve, Jeremy Corbyn, i cili kundërshton Brexitin, por nuk propozon zgjedhje.



Presidenti Trump deklaroi krizë humanitare në kufirin me Meksikën

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha në fjalimin e tij të parë nga Zyra Ovale, se kishte rritje të krizës humanitare në kufirin me Meksikën, por Trumpi nuk e shpalli gjendjen e emergjencës kombëtare ashtu siç pritej para fjalimit



UASHINGTON, 9 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i kërkoi Kongresit në një fjalim televiziv të martën 5.7 miliardë dollarë për ndërtimin e murit në kufirin me Meksikën. Trumpi tha në fjalimin e tij të parë nga Zyra Ovale se kishte rritje të krizës humanitare në kufirin me Meksikën. Megjithatë, Trumpi nuk e shpalli gjendjen e emergjencës kombëtare ashtu siç pritej para fjalimit. Por, pas disa ditësh ai mund t'i përdorë fuqitë presidenciale për ta shpallur emergjencën si një hap të parë drejt sigurimit të parave për murin pa miratimin e Kongresit. Presidenti Trump tha se do të vazhdojë të kërkojë një zgjidhje për ngërçin me Kongresin.

dhe kundërshtimi i demokratëve në Kongres për ta votuar atë. Presioni publik ndaj mbylljes së Qeverisë, po rritet dhe kjo mund të dëmtojë Trumpin. Ai muajin e kaluar deklaroi se do të jetë krenar për të mbyllur Qeverinë në këmbim të luftës për ndërtimin e murit. Menjëherë pas fjalimit të Trumpit i cili u transmetua drejtpërdrejt, udhëheqësit demokratë po ashtu mbajtën një fjalim ku akuzuan presidentin se po përdor taktikë të frikës dhe po përhap keqinformim rreth situatës përgjatë kufirit. "Presidenti ka zgjedhur frikën. Ne duam të fillojë me faktet",

tha Nancy Pelosi, kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve. "Fakti është se presidenti Trump ka zgjedhur të mbajë peng shërbimet kritike për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e popullit amerikan dhe të ndalojë pagat e

800,000 punëtorëve të pafajshëm në mbarë vendin, shumë prej tyre veteranë", tha ajo. Pelosi më parë e kishte quajtur ndërtimin e murit të pamoralshëm dhe pikërisht me këtë deklaratë u mor edhe presidenti

Trump gjatë fjalimit të tij. "E vetmja gjë që është e pamoralshme është kur politikanët nuk bëjnë asgjë dhe vazhdojnë të lejojnë që shumë njerëz të pafajshëm të jenë tmerrësisht të viktimizuar", tha ai.

Demokratët në Kongres po kundërshtojnë votimin e buxhetit që parasheh edhe mjetet për ndërtimin e murit me Meksikën. Presidenti Trump me një gjuhë të hapur tha se emigrantët ilegalë dhe drogat që qarkullonin në gjithë kufirin jugor përbënin kërcënim serioz për sigurinë amerikane. "Edhe sa gjak amerikan duhet të derdhet përpara se Kongresi të bëjë punën e vet", tha Trumpi duke rrefyer detaje të tmerrshme të vrasjeve që ai thoshte se ishin kryer nga emigrantët e paligjshëm. Fjalimi i presidentit u mbajt 18 ditë pas mbylljes së pjesës së Qeverisë e shkaktuar nga kërkesa e tij për ndërtimin e murit

Sekretari Pompeo vizitë të paparalajmëruar në Irak

UASHINGTON, 9 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, bëri të mërkurën një vizitë të paparalajmëruar në Irak, ku u takua me kryeministrin Adel Abdul-Mahdi dhe zyrtarë të tjerë. Pompeo po zhvillon një tur njëjavor në Lindjen e Mesme për t'u dhënë sigurime aleatëve në klimën e planeve amerikane të tërheqjes nga Siria si dhe për të kërkuar mbështetje për rritjen e presionit ndaj Iranit.

Pompeo u takua edhe me presidentin Barham Salih, ministrin e



Jashtëm Mohamed Alhakim si dhe personelin ushtarak amerikan atje. Në takimim me kryetarin e Parlamentit të Irakut, Mohamed al-Halbousi, Pompeo theksoi angazhimin për "trajtimin e sfidave të sigurisë së Irakut, përfshirë vazhdimin e partneritetit

amerikan me forcat e sigurisë".

Udhëtimin e tij diplomatik më i lartë amerikan e nisi të martën me një vizitë në Jordani. Ai premtoi t'i dyfishojë përpjekjet diplomatike e tregtare për të ushtruar siç tha ai "presion të vërtetë mbi Iranin", për të ndryshuar ato që administrata Trump i cilëson sjellje keqdashëse në rajon. Pompeo pritet, gjithashtu, t'i vizitojë Egjiptin, Bahrenin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katarin, Arabinë Saudite, Omanin dhe Kuvajtin.

Ndërkaq udhëheqësi i demokratëve të Senatit, Chuck Schumer i cili u paraqit së bashku me Nancy Pelosin, i bëri thirrje presidentit të mundësojë rihapjen e Qeverisë përderisa debati për politikën e emigracionit vazhdon. "Simboli i ShBA-së duhet të jetë Statuja e Lirisë dhe jo një mur i gjatë. Pra, sugjerimi ynë është i thjeshtë. Zoti president: Rihapeni Qeverinë dhe mund të punojmë për të zgjidhur dallimet tona lidhur me sigurinë e kufirit. Por, përfundojeni këtë mbyllje tani", tha Schumer. Demokratët gjithashtu e arsyetojnë qëndrimin e tyre me faktin se mjetet e teknologjisë së lartë do të ishin më të lira dhe më efektive për sigurimin e kufirit.

Turqia refuzon ShBA-në, mban qëndrim të njëjtë ndaj kurdëve

ANKARA, 9 JANAR - Ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, thotë se Turqia nuk do të përmbahet nga veprimet ushtarake për t'i mbrojtur kufijtë e saj, nga ajo që ai e përshkruan si kërcënim prej luftëtarëve kurdë të Sirisë. Deklarata e ministrit u bë të mërkurën, një ditë pasi Turqia hodhi poshtë kërkesën e

këshilltarit për siguri kombëtare të SHBA-së, John Bolton, i cili kërkoi që Ankaraja t'i mbrojë luftëtarët kurdë në pjesën verilindore të Sirisë, para se trupat amerikane të tërhiqen nga rajoni, transmeton Associated Press. Kurdët në Siri janë aleat të Shteteve të Bashkuara.

Refuzimi i Turqisë përforcoi një përçarje midis Ankarasë dhe Uashingtonit, dhe ngriti pyetje të reja rreth asaj se si Shtetet e Bashkuara do të mbronin luftëtarët që janë aleatë të ShBA-së në luftën kundër grupit të Shtetit Islamik. Turqia i konsideron luftëtarët kurdë si terroristë.



Dhuna seksuale nga forcat ushtarake serbe ndaj grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë (4)

Diplomacia kosovare dështoi ta dëshmonte krimin e forcave serbe gjatë luftës në Kosovë



Elife LUZHA

- Pushtimi i Kosovës dhe represioni serb mbi shqiptarët etnikë

Duhet thënë se në Bosnjë për dhunën seksuale gjatë luftës janë gjykuar më shumë persona se në çdo vend tjetër të botës. Bosnja, pavarësisht prej problemeve, është shembull edhe sa i përket përmbushjes së të drejtave të mbijetuarve të dhunës seksuale.

Kosova në raport me Bosnjën ka dallime të mëdha sa u përket të dënuarve për krime të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Organizata për të Drejtat e Njeriut, Amnesty International, ka publikuar vetëm 7 raste të lidhura me përdhunimet sistematike në gjykatat e Kosovës. "Gjykatat Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ka shpallur fajtorë 4 persona për dhunime gjatë kohës së luftës në Kosovë, përderisa shumë pak gra

kanë dëshmuar në proceset gjyqësore. Fondi për të Drejta Humanitare, që monitoron gjykimin e krimeve të luftës, paralajmëron se në shumë raste dëshmitarët në gjykime kundër të pandehurve që akuzohen për përdhunim janë fyer dhe janë ekspozuar ndaj sjelljeve degraduese nëpër gjykime(kosovotwopointzero.com).

Komisioni i Verifikimit të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë ka raportuar se mbi 750 të mbijetuarat kanë aplikuar për statusin e të mbijetuarve, por vetëm 140 kanë marrë përgjigje pozitive.

"Në Kroaci, Ligji për të Drejtat e Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Agresionit të Armatosur kundër Republikës së Kroacisë në Luftën për Atdhe u miratua më 2015, duke themeluar statusin ligjor të viktimës së dhunës seksuale. Ky ligj u ofron atyre që e marrin këtë status një pagesë mujore, si dhe të drejtën për kujdes shëndetësor, rehabilitim mjekësor dhe ndihmë psikologjike. Ndryshe nga Kosova, në Kroaci nuk ka afat të fundit për dorëzim të kërkesave" (po aty).

Sipas Rosa Centerfor Women Victimsof War, një OJQ me qendër në Zagreb, që ofron mbështetje për viktimat e luftës dhe të formave të tjera të

dhunës, vetëm 215 persona kanë aplikuar për statusin formal deri në mes të vitit 2018 dhe vetëm 132 prej tyre ishin të suksesshëm. Dhënia e dëshmërbimit për personat që i mbijetuan dhunës seksuale duhet të shoqërohet me përpjekje nga e gjithë shoqëria për ta njohur problemin dhe për të luftuar kundër stigmatizimit dhe viktimizimit dytësor të personave që i mbijetuan dhunës dhe familjarëve të tyre (po aty).

Diplomacia kosovare dështoi të dëshmonte krimin e forcave serbe gjatë luftës në Kosovë!

Njohja e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, ishte synim, por edhe detyrë e udhëheqësve të vendit. Funksionimi i shtetit pritej të realizohej përmes fuqizimit të institucioneve të pavarura, demokratik edhe zhvillimit të gjithanshëm shoqëror. Por, që në hapat e parë të shtet-ndërtimit, Kosova ka ngecur sidomos në përkujdesjen dhe rehabilitimin e nevojshëm të mbijetuarve nga lufta, siç janë gratë, ndaj të cilave u aplikua krimi i dhunës seksuale nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë.

U deshën 15 vite pritje, deri më 2014, që të miratohet Ligji për Mbrotjtjen e Viktimave të Dhunës Seksuale, por në asnjë mënyrë ky ligj nuk mund të ofronte edhe

drejtësinë e munguar. "Unë jetoj e vdekur dhe më marrin për të gjallë", ishte rrëfimi i njëres nga gratë, por në fakt, me dhunimin e tyre "a s'jemi të dhunuar të gjithë?" (Kadare, 2011:18). Madje, qeveritë e pasluftës nuk e panë të udhës që çështjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale ta shtrojnë në tryezën e bisedimeve Kosovë-Serbi.

Tribunali Penal Ndërkombëtar (TPNJ)dhunën seksuale ndaj grave gjatë luftës në ish-Jugosllavie definoi si krim kundër njerëzimit. Por institucionet e Kosovës, krimin serb në Kosovë nuk arritën ta dëshmojnë para këtij tribunali. "Etja për pushtet e para, e hiç më pak edhe për lavdi, ka bërë që udhëheqësit e institucioneve të Kosovës të humbin rastet për dëshmimin e krimit serb në Kosovë. Sado paradoksale të duket, nga dëshmimi i krimeve do të përfitonin të gjithë, duke përfshirë edhe ata që i kishin kryer ato" (Kadare,2011: 12).

"Heshtimi për krime është më i pafalshmi gabim i shqiptarëve", thotë I. Kadare (Kadare, 2011, 11). Madje është rrezik që "mosndëshkimi të mbetet tmerri më i madh i Kosovës, që edhe mund të dyzohet (Kadare, 2011, 11).

Politika e jashtme kosovare nëpërmjet diplomacisë publike, (diplomacia publike përfshin aktivizimin e një grupi të madh

"lojtarësh" të organizuar për arritjen e synimeve të caktuara) dhe takimeve me shtete e organizata të ndryshme, duhet ta ndërkombëtarizojë krimin e gjenocidit serb në Kosovë. Të gjitha përfaqësitë diplomatike të Kosovës nëpër botë duhet të jenë të pajisura me informata të mjaftueshme, qoftë edhe me botime të broshurave shtesë, ku specifikohen rastet e dhunës dhe të udhëzohen për njoftimin e shteteve pritëse për krimin e ndodhur në Kosovë.

Edhe përfaqësitë e huaja në Kosovë duhet të informohen për krimin e gjenocidit serb në Kosovë. Diplomacia aktive e Kosovës do të duhej të ushtronte trysni, që shteti serb të pranonte krimin e gjenocidit të kryer në Kosovë, ashtu siç pranoi të nënshkruajë në Stamboll rezolutën, e cila dënonte si gjenocid masakrën e Srebrenicës në Bosnjë. Me çdo kusht, diplomacia kosovare duhet të zgjojë interesimin e bashkësisë ndërkombëtare për krimin e dhunës seksuale nga forcat serbe ndaj 20000 grave shqiptare në Kosovë, me këtë edhe dënimin e tij. Kjo zaten është në të mirën edhe të vetë Serbisë. Ndryshe, "duke mos i dhënë lamtumirë krimit, do të dëmtohej më tej jo vetëm Serbia, por krejt programi i paqes në Ballkan", thotë I. Kadare (Kadare, 2011:15). (Fusnotat i ka hequr redaksia /Fund)

Nënshkruhet programi nacional për rininë edhe me Komunën e Kamenicës

KAMENICË, 9 JANAR (ER) - Rexhep Hoti, Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, të mërkurën ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, për implementimin e Programit Nacional për Rininë për të gjithë nxënësit dhe studentët e kësaj komune. "Programi Nacional për Rininë nuk është vetëm garë. Është punë individuale, ekipore dhe, para së gjithash, është gjithëpërfshirje e dijes e sublimuar në pjesën praktike të saj, që do të thotë se teorisë i jepet shans të takohet me praktikën, me pjesën më të bukur të dijes që i bën nxënësit të jenë më kureshtarë dhe ambiciozë e aspak monoton", ka thënë koordinatori Hoti.

Kryetari i Kamenicës ka vlerësuar se një program i tillë ka qenë më se i nevojshëm për të rinjtë. "Jemi shumë të interesuar dhe të gatshëm që ta mbështesim dhe

implementojmë programin në komunën tonë me të gjitha mundësitë. Është një program i jashtëzakonshëm sepse bazohet në garë, e konkurrenca është e domosdoshme për rininë. Të rinjtë e komunës sonë janë shumë aktivë, sidomos në sport, prandaj besoj se gara do të jetë shumë interesante", ka thënë Kastrati.

Koordinatori Hoti ishte i shoqëruar nga zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Leonora Morina-Bunjaku dhe zëvendësministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Azem Guri, të cilët theksuan mbështetjen e ministrive që përfaqësojnë për programin. Qëllimi i marrëveshjes së bashkëpunimit është asistimi i ndërsjellë për implementimin e Programit Nacional për Rininë si dhe aranzhimin e përbashkët të aktiviteteve që kanë për synim promovimin e diturisë, kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik si dhe sportit.



E jashtëzakonshme

Ngeci brenda kutisë së donacioneve, vdes gruaja

Një grua ka vdekur pasi mbeti e bllokuar në një kuti të donacionit të veshjeve në një rrugë në Toronto. Policia zbuloi gruan e pajetë brenda kutisë së donacioneve rreth orës 1:30 të mëngjesit të së mërkurës në Toronto. Zjarrfikëset prenë kutinë e donacioneve për ta



shpëtuar, por ishte tepër vonë. Gruaja, rreth 35 vjeç, u konstatua e vdekur në vendngjarje.

FOTO E DITES



Një grua vietnameze shihet duke mbledhur shkopinj në fshatin Quang Phu Cau në periferi të Hanoi. /AFP/

E rrallë

Papuçet me mesazhet e Trumpit në 'Twitter' u shitën të gjitha brenda një kohe të shkurtër

Artisti nga Los Anxhelosi, Sam Morrison, ka krijuar një model interesant të papuçeve. Ai ka mbledhur rreth 40 mijë postime të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, në rrjetin social "Twitter". Kështu ato postime ky i ka shtypur në papuçe. Sam Morrisoni



filloi shitjen e papuçeve me titullin Trump përmes një faqe interneti të quajtur PresidentFlipFlops.com.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: Pse nuk më ke treguar me kohë që nuk ke para?

Burri: Vazhdimisht të thosha more se, përveç teje, s'kam kurrgjë, e ti veç qeshje.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.


Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Do t'ju lindin disa probleme në fushën profesionale sot që do të duhet medoemos t'i zgjidhni. Jeni në udhëkryq dhe po tentoni ta gjeni drejtimin.</p>	 <p>DEMI Sot jeni në fushë të hapur me kundërshtarët tuaj. Duhet të keni kujdes nga ata që ende nuk janë shfaqur përballë jush.</p>	 <p>BINJAKËT Do ta keni të vështirë t'i keni nën vëzhgim personat me të cilët keni marrëdhënie pune. Shumë prej tyre janë të prirë të neglizhojnë.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk mund të gënjeni sot ata persona që rrinë pranë jush. Edhe pse po tentoni t'i fshihni ndjenjat tuaja, dikush do të zbulojë çfarë ju shqetëson.</p>	 <p>LUANI Edhe pse nuk po e pranoi, keni nevojë të keni pranë vetes një person të caktuar që dashur padashur jua ndryshon humorin dhe ju kthen buzëqeshjen.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Mungesa e besimit ju ka bërë më të ftohtë në marrëdhënie me të tjerët. Jo me të gjithë mund të mbani të njëjtin qëndrim indiferent.</p>
 <p>PESHORJA Tregohuni më të hapur me të tjerët dhe ata do të bëjnë çmos t'ju tregojnë mirënjohje. Zgjidhni personat që besoni në rrugën tuaj.</p>	 <p>AKREPI Duhet ta vini veten në vend të dikujt tjetër që të mund të gjykoni një situatë të caktuar. Jo gjithmonë gjërat janë ashtu siç duken.</p>	 <p>SHIGJETARI Problemet tuaja zgjidhni përpara se të jetë shumë vonë. Dikush do të luajë një lojë të pisët nga e cila do të dilni jo pak të lënduar.</p>	 <p>BRICJAPI Të konkretizoni atë që keni në mendje sot nuk do të jetë shumë e vështirë. Mjaft të flisni me njerëzit e duhur dhe gjërat do të realizohen.</p>	 <p>UJORI Sot mos kaloni në sulm kur t'ju pyesin për gjëra shumë të thjeshta. Nervozizmi juaj do të lerë të kuptohet që ka diçka që nuk shkon.</p>	 <p>PESHQIT Nuk keni mundur t'u jepni përgjigje dyshimeve të shumë personave sot. Nëse e lini të kalojë këtë situatë, gjërat thjesht do të mbeten pa sqaruar.</p>

Pink merr mesazh emocionues nga burri në përvjetorin e 13-të të martesës



Carey Hart ka shprehur edhe një herë dashurinë e vet për Pinkun. 43-vjeçari ka uruar në "Instagram" gruan në përvjetorin e 13-të të lidhjes së tyre. "Nuk mund të besoj se është përvjetori ynë i 13 i martesës. Kush do të kishte menduar

që dy të paaftë si ne mund t'ia dalin. Jam shumë mirënjohës për ty. Ne kemi krijuar një jetë dhe familje të mrekullueshme së bashku. Të dua", ka shkruar Carey. Pink dhe Carey u martuan në vitin 2003 dhe janë prindër të dy fëmijëve.

Diane Kruger kërkon privatësi për vajzën e porsalindur



Aktorja 42-vjeçare, Diane Kruger, ka kërkuar nga fansat, paparacët dhe të gjithë të tjerët, që ta respektojnë privatësinë e vajzës së saj të sapolindur, për të mos publikuar fotografi online. Kruger dhe i dashuri i saj Norman Reedus së fundmi

mirëpritën vajzën e tyre në botë. "Të dashur fansa, adhures, paparacë dhe të gjithë të tjerët. Ne ishim të etiketuar në këtë foto. Këto imazhe janë bërë pa pëlqimin tonë dhe ekspozojnë një fëmijë të pafajshëm", ka shkruar aktorja Kruger në "Instagram".



Donald Trumpi tallet nga Bebe Rexhën në "Instagram"

Këngëtarja me origjinë shqiptare, Bebe Rexha, e cila ndiqet nga mbi 7.2 milionë njerëz në "Instagram", është mjaft aktive duke publikuar fotografi apo video të ndryshme nga përditshmëria e saj. Jo të rralla janë rastet kur ajo ndan me ndjekësit ndonjë imazh argëtues ose ironizues.



CupcakKe tentoi të vetëvritej



CupcakKe ka kërkuar ndihmë profesionale pasi ka bërë një cicërimë alarmante në "Twitter". Reperja 21-vjeçare, emri i së cilës është Elizabeth Eden Harris, konfirmoi se ajo po ndihet e pasigurt dhe se ishte gati për të bërë vetëvrasje. "Unë kam qenë

duke luftuar me depresionin për një kohë të gjatë, më falni që nuk e kam bërë publike, por jam mirë. Shkova në spital dhe më në fund po gjej ndihmën të jem e lumtur dhe të bëj muzikë të mirë. Faleminderit për të gjitha lutjet! Ju lutem, mos u shqetësoni për mua", ka thënë ajo.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	REAL BETIS - REAL SOCIEDAD	1	ATHLETIC BILBAO - SEVILLA	2	AL WEHDA - AL FATEH	3+
-------------------	----------------------------	---	---------------------------	---	---------------------	----

Ndryshime te Gjilani, dy largime dhe një transferim

GJILAN, 9 JANAR (ER) - Klubi i Futbollit Gjilani është mjaft aktiv këtë afat kalimtar dimëror. KF Gjilani me anë të postimeve në rrjetet sociale ka konfirmuar lëvizjet e fundit në këtë klub. Fillimisht është konfirmuar largimi i dy lojtarëve, Edon Sadriu dhe Ergon Hyseni, të dy lojtarë nga Ferizaj. Nuk ka vonuar shumë dhe Gjilani ka bërë prurjen e re nga Novi Pazari. Bëhet fjalë për futbollistin me përvojë, Semir Hadzibulic, i cili ka nënshkruar kontratë deri në verën e vitit 2020. Më parë ky futbollist ka qenë pjesë e Ki Klaskvik nga Ishujt Faroe. KF Gjilani me këto ndryshime konfirmon pretendimet për ta përmirësuar renditjen tabelore në stinorin pranveror.



Taulant Xhaka në garë për golin e vitit në Zvicër

PRISHTINË, 9 JANAR - Lojtari i Baselit, Taulant Xhaka, është në garë për golin e vitit në ligën elitare zvicerane. Goli i tij është në mesin e pesë më të mirave për vitin që shkoi. Krahas tij, së bashku në garë janë edhe Dennis Hediger i FC

Thunit, pas tij vjen Guillaume Hoarau i BSC Young Boys, Xhaka është i treti në nominim, pas tij vjen Simon Greter i FC Luzernit. Listën e përmbyll Carlinhos Junior i FC Luganos, ka njoftuar Federata e Futbollit Zviceran.




NBA, triumfojnë LA Clippersi dhe Golden State

NEW YORK, 9 JANAR - Los Angeles Clippersi regjistroi fitoren e dytë radhazi në NBA pasi mposhti Charlotte 128-109 dhe forcoi vendin e katërt në renditjen e Konferencës së Perëndimit. Shënuesi më i mirë i sfidës për kalifornianët ishte i zakonshmi Lou Williams me 27 pikë, edhe pse ndeshjen e nisi nga stoli. Një rol protagonist i pati edhe Danilo Gallinari që e mbylli sfidën me 20 pikë, 12 nga të cilat i shënoi në 9 minutat e para të ndeshjes. Pikërisht falë pikëve të italianit. Clippersi që drejtohet nga Doc Riversi e mbylli periudën e parë 33-24.

Charlotti arrin ta reduktojë diferencën deri në dy pikë, por në periudën e tretë Clippersi u arratis sërish në rezultat duke e thelluar avantazhin në 18 pikë për ta mbyllur me sukses këtë sfidë. Ashtu sikurse LA Clippersi, edhe Golden State shënoi fitoren e dytë radhazi në sfidat e radhës. Skuadra kampione në fuqi dominoi ndaj New Yorkut të cilin e mundi 122-95. Njeriu i ndeshjes për Warriorsin u bë Klay Thompson që u shfaq si një sniper i vërtetë në parket teksa shënoi 43 pikë në 34 minuta lojë, 21 nga ta cilat nga distanca e tri pikëve.



Buffoni flet për çastet e vështira kur luante për Juventusin



PARIS, 9 JANAR - Gianluigi Buffon ka rrëfyer në "Vanity Fair" çastet e vështira në fillim të aventurës së tij me Juventusin. Portieri i PSG-së ka treguar se ka vuajtur nga depresioni dhe në një prej ndeshjeve mungoi mes shtyllave pasi pësoi një sulm paniku. "Për disa muaj, për mua nuk kishte më

kuptim asgjë. Më dukej sikur të gjithë interesoheshin për Buffonin, jo për Gigin. Ishte një çast shumë i vështirë i jetës sime", ka thënë ai, duke shtuar se: "Isha 25 vjeç, isha i suksesshëm, por një ditë, përpara një ndeshjeje, i thashë trajnerit të portierëve se nuk luaja dot. Pata

një sulm paniku dhe nuk isha në gjendje që të luaja", u shpreh 40-vjeçari. Sipas Buffonit, një çast kaq i vështirë e lejoj që ta vazhdonte karrierën me sukses: "Kurrë nuk kam pasur frikë t'i tregoj pasiguritë e mia dhe kurrë nuk kam pasur frikë të qaja. Unë qaj dhe nuk kam aspak turp për këtë".

Egjipti do ta organizojë Kupën e Kombeve të Afrikës


KAJRO, 9 JANAR - Do të jetë Egjipti vendi që do ta organizojë turneun më të rëndësishëm të futbollit në kontinentin afrikan këtë vit. Kupa e Kombeve 2019, e cila është programuar të zhvillohet

nga 15 qershori deri më 13 korrik, këtë verë nuk do të organizohet në Kamerun, siç ishte vendosur fillimisht, por në anën tjetër të kontinentit. Konfederata afrikane e Futbollit vendosi t'ia

japë Egjiptit të drejtën për turneun emocionues, pas vonesave të Kamerunit në ndërtimin e impianteve dhe faciliteteve për fazën finale por, para së gjithash, për shqetësimet në rritje për

nivelin e dobët të sigurisë. Raportohet nga mediet e huaja se rrëmbimet potenciale dhe sulmet terroriste janë një nga motivet që e shtynë Kupën e Kombeve drejt Kajros.



					Autor: GAZMEND MORINA	MYNXYRË; HALL I MADH	KUNDREJ PROLOG	SËMUNDJE E RËNDË QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.)	▼	NË TË VËRTETË; MADJE ARIANIT (perkdh.)	EPOKA ERE	VENDI KU PULA PJELL VEZËT, FURRIK (krah.)	AKTORI HOLLIVUDIAN SANDLER	INAT QË NA HIPËN KUNDËR DIKUJT A DIÇKAJE	HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND"	NORA ISTREFI
					SYSHTRËM- BËR	GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE	MJET PREJ TUNXHI, SI KAMBANË FARE E VOGËL (sh.shq.)	HOV, VRULL	HALLKË E HEKURT QË I VIHET BOSHTIT TË RROTAVE TË QERRS	EPOKA ERE	SHKRONJA XV	KËNGËTARJA BARAKU BIXHOZ	ZULMË KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE	MICHIGAN ASSOCIATION REALTORS DESPOTIK	ZHANËR I MUZIKËS	I KAPËRDIJ PASANIKJA
EPOKA ERE	KËNGËTARJA NË FOTO	NDJENJA QË KEMI KUR JEMI PA NGRËNË	LLOJ HELMI LUFTE	NEON	EPOKA ERE	UNITED KINGDOM BASHKËT.	TENISTI I SHQUAR ENDI BASHKËT.				JEMENI, INDONEZIA KALORËS MESJETAR					
DEL PËR GJAH	○				ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY HATA				LLOJ LETRASH FATI KORIJA							
MODEL MOSTËR (turq.)	○				INVA MULA KORNIZË		SHKRIMTARI TURK HIKMET (shq.) SPORTIST QË MERRRET ME NOT				ZANORE ESTONIA, LITUANIA					
SILIC, TON	○			RAFTI VËLLAI I MADH					QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJTË (F.)				AKTORJA ISMAILI			
MURI ME DËRRASA	○				LLOJ GRURI I SHKURTËR, ME KALLI PA HALA LLOJ SHPENDI				LLOJ SHTRATI MË DY DR- URË ANASH PJESËTAR I NJË POPULLI NË SI LANKË							
ZANORE	○	ANTON PASHKU INSTRUMENT MUZIKOR			DY BASHKË- TINGËLLORE NJOLLA		BASHKËT. SHKRONJA XIX		GRADË NË USHTRI PJESËTARI I NJË FISI ILIR				BASHKËT. VËLLAI I BURRIT			
QË ËSHTË KRIJUAR PËR TU KËNDUAR; ZANOR	○				ARKEOLOGU SKËNDER RITUALE						GJELBËRIM	KLINT ISTVUD BAKËR				
→	○			TË BUKURIT KËNGËTARE E FAMSHME AMERIKANE			JEVGU LLOJ METALI				LEGJENDA E "KUNG FU-së" LEE (shqip.) EUROPEAN MUSIC OFFICE					
SHKËLQIM I VENDIT KU JETOJMË NOTË MUZIKORE	○		BASKETBO- LLISTI MALIQI VEGËL MUZIKORE				VARIOLË RRAHJE ME SHKOP (shq.)			SHKRIMTARJA KADARE						
FEMRAT E ARIUT	○				IDHULL DY BASHKË- TINGËLLORE					KËNGËTARJA VALBONA GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ			TËRËSIA E ANIJEVE LUFTARAKE			
→	○			NERGÛT NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË (shq.)					VRIMË SHUMË E VOGLA NË DIÇKA SEKRETARI I OKB-së BAN KI			DY BASHKË- TINGËLLORE ISH BASKET- BOLLISTI YNË ALEKSANDER				
E VADITA, E		NËNDARJA E NJË LIGJI KOD I TELEFONIT CELULAR			KUNDREJT NDALIMI TAKOJ DIKË A DIÇKA RASTËSISHT						JETË PA TRAZIME (libr.) FUTBOLLISTI SAMUEL ...					
PAMELA ANDERSON			TURN KLUB HANNOVER NAIM ABAZI				NOTË MUZIKORE NAIM ISMAJLI		KLERIK I SHKOLLUAR MYSLIMAN DUKAT				ZANORE ISMET JASHARI			
ZANORE		LLOJ VETURE JAPONEZE SHKRONJA X-16					SECILA NGA FLETËT QË MBYLLIN DRITAREN TROYES				GOJËDHËNË BASHKËT.					
PREJ KU				I VËNË NË SITË					FOTOGRAFIA (bised.)							



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Njësia e Personelit / Jedinica za Personel / Personnel Unit



01Nr/Br: 56

Me datë/Dana: 09.01.2019.
Rahovec/Orahovac

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Komuna e Rahovecit bën: Na osnove člana 12. Stav 4. Zakona Br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova, Zakona Br. 04/L-077 za Obligacioni Odnosi, Opština Orahovac, javno:

Shpallje të konkursit publik për marrëveshje për shërbime të veçanta Objavluje javni konkurs za sklapanje sporazuma o posebnim uslugama

Emri i Institucionit : Komuna e Rahovecit /Drejtoria për Administratë.
Nazim Institucije: Opština Orahovac/ Odeljenja Uprave

Titulli i punës: Punëtor të pastrimit - (7 vende pune)
Nazim Radnog Mesta: Čistač – (7 radna mesta)

Numri i referencës: DA/1-2019 /MSHV
Broj reference: O.Z.U/ 1- 2019 /MSHV

Tarifa e shërbimit: 237.72 Euro bruto
Tarifa ushruje: 237.72 Evra bruto

Raporton te: Drejtorit të Drejtorisë për Administratë
Izveštava: Direktor Odeljenja za Uprave

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Vrsta ugovora: Sporazum o Posebnim Uslugama – (MSHV)

Kohëzgjatja e kontratës: Deri sa Komuna e lidhë Kontratën e Shërbimit të pastrimit me operatorin fitues të tenderit.

Rok ugovora: Sve do sklapanja ugovora Opštine sa Kompanijom koja je dobila tender.

Orari i punës: 1 plotë, 40 orë në javë
Radno Vreme: Puno radno vreme, 40 sati nedeljno

Lokacioni: Rahovec
Lokacija: Orahovac

Detyrat dhe përgjegjësitë:
1.Pastrimi i hapsirave të objektit të administratës

Dužnosti i odgovornosti:
1.Čišćenje prostorija objekta administracija

Shkathësitë e kërkua:
- Përvojë e punës
Potrebne sposobnosti:
- Radno iskustvo

Dokumentet:
Certifikata e lindjes
Kopja e letërnjoftimit
Dokumenta:
Izvod rodenja
Kopija lične karte

Komuna e Rahovecit mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.
Opština Orahovac očekuje aplikacije od svih lica muškog i ženskog roda svih zajednica.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim e të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Uslovi učesća na konkursu:

Pravo na konkurs za ovaj položaj imaju državljani Republike Kosova zrelog doba, koji imaju potpunu sposobnost za delovanje, poseduju građanska i politička prava, poseduju potrebnu školsku i stručnu spremu za izvršavanje zadataka i koji poseduju fizičku sposobnost koja se traži za dotični položaj.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e komunës së Rahovecit dhe shtypin ditor.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs ostaje otvoren 5 kalendarskih dana od dana objave na internet stranici opštine Orahovac i dnevnoj štampi.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Zyrën e pranimit të komuns së Rahovecit, dhe dorëzohen në Zyrën e pranimit të komunës së Rahovecit, në adresën: Ndrëtesa e re të komunës së Rahovecit- Kati përdhësë -Rahovec, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00.

Podnošenje zahteva: Formulari za aplikaciju mogu se uzeti u Prijemnoj kancelariji opštine Orahovac, i dostavljaju se u Prijemnoj kancelariji opštine Orahovac, na adresi: Nova zgrada opštine Orahovac – Prvi sprat – Orahovac, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, časova.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 044/203-914.
Za više informacija možete da kontaktirate na br.tel. 044/203-914.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.
Aplikaciji treba dostaviti: Kopiju lične karte, kopiju dokumentacija kvalifikacija, kao i ostale potrebne dokumentacije potrebne prema konkursu.

Datat e mbajtjes së intervistave për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs,do të publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit.

Datum za održavanje intervjua z akandidate koji će ispuniti uslove predviđene prema ovom konkursu, biće objavljen na zvaničnoj internet stranici opštine Orahovac.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Njësia e Personelit / Jedinica za Personel / Personnel Unit



01Nr/Br: 55

Me datë/Dana: 09.01.2019.
Rahovec/Orahovac

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Komuna e Rahovecit bën: Na osnove člana 12. Stav 4. Zakona Br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova, Zakona Br. 04/L-077 za Obligacioni Odnosi, Opština Orahovac, javno:

Shpallje të konkursit publik për marrëveshje për shërbime të veçanta Objavluje javni konkurs za sklapanje sporazuma o posebnim uslugama

Emri i Institucionit : Komuna e Rahovecit/ Drejtoria për Administratë
Izveštava: Opština Orahovac / Odeljenja za Uprave

Titulli i punës: Punëtor të sigurimit fizik-roje - (4 vende pune)
Nazim Radnog Mesta: Radnik fizičke bezbednosti - stražar (4 radna mesta)

Numri i referencës: DA/2-2019 /MSHV
Broj reference: O.Z.U/2-2019/MSHV

Tarifa e shërbimit: 237.72 Euro bruto
Tarifa ushruje: 237.72 Evra bruto

Raporton te: Drejtorit të Drejtorisë për Administratë
Izveštava: Direktor Odeljenja za Uprave

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Vrsta ugovora: Sporazum o Posebnim Uslugama – (MSHV)

Kohëzgjatja e kontratës: Deri sa Komuna e lidhë Kontratën e Shërbimit të sigurimit të objekteve me operatorin fitues të tenderit.

Rok ugovora: Sve do sklapanja ugovora o usluzi bezbednosti objekata sa kompanijom koja će dobiti tender.

Orari i punës: 1 plotë, 40 orë në javë
Radno Vreme: Puno radno vreme, 40 sati nedeljno

Lokacioni: Rahovec
Lokacija: Orahovac

Detyrat dhe përgjegjësitë:
1.Sigurimi fizikë i hapsirave të objektit të komunës

Dužnosti i odgovornosti:
1. Fizička bezbednost prostorija objekta opštine
Shkathësitë e kërkua:
- Përvojë e punës
Potrebne sposobnosti:
- Radno iskustvo

Dokumentet:
Certifikata e lindjes
Kopja e letërnjoftimit
Dokumenta:
Izvod rodenja
Kopija lične karte

Komuna e Rahovecit mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.
Opština Orahovac očekuje aplikacije od svih lica muškog i ženskog roda svih zajednica.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim e të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Uslovi učesća na konkursu:

Pravo na konkurs za ovaj položaj imaju državljani Republike Kosova zrelog doba, koji imaju potpunu sposobnost za delovanje, poseduju građanska i politička prava, poseduju potrebnu školsku i stručnu spremu za izvršavanje zadataka i koji poseduju fizičku sposobnost koja se traži za dotični položaj.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e komunës së Rahovecit dhe shtypin ditor.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs ostaje otvoren 5 kalendarskih dana od dana objave na internet stranici opštine Orahovac i dnevnoj štampi.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Zyrën e pranimit të komuns së Rahovecit, dhe dorëzohen në Zyrën e pranimit të komunës së Rahovecit, në adresën: Ndrëtesa e re të komunës së Rahovecit- Kati përdhësë -Rahovec, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00.

Podnošenje zahteva: Formulari za aplikaciju mogu se uzeti u Prijemnoj kancelariji opštine Orahovac, i dostavljaju se u Prijemnoj kancelariji opštine Orahovac, na adresi: Nova zgrada opštine Orahovac – Prvi sprat – Orahovac, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, časova.

